

Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Emri dhe Mbiemri i Ekspertit Shqyrtues	Nënshkrimi	Data e autorizimit të Ekspertit	Data e pranimit të autorizimit nga Eksperti	Data e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës:
Daut Retkoceri		23.01.2023	24.01.2023	06.02.2023	44/23

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 18.01.2023 Operatori Ekonomik: “Alb -Architect ” SH.P.K, Prishtinë ka parashtruar ankesë me numër PSH. Nr. 44/23, pjesëmarrës në ftesën për ofertë lidhur me aktivitetin e prokurimit: ” Konsulencë për themelimin e Shërbimit të Arkitektit të Kryeqytetit për nevojat e Komunës së Prishtinës “ me numër të prokurimit: 616-22-7431-3-1-2 iniciuar nga AK/ – KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS, kundër kërkesave diskriminuese të vendosura në NJOFTIMIT PËR KONTRATË të publikuar me datën 21.07.2022 dhe DOKUMENTE TE TENDERIT të publikuara përmes platformës e-prokurimi.rks-gov.net me datën 08.12.2022

Autoriteti kontraktues ka zbatuar – “SHERBIMET KONSULENTE” PROCEDURË E KUFIZUAR FAZA 2

vlera e parashikuar e kontratës: 12,000,000.00 €

Konform nenit 113,114 të Ligjit Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

TË DHËNAT MBI AKTIVITETIN E PROKURIMIT

Procedura e Kufizume, kontrata kornize;

Data e dorëzimit të Njoftimit të Kontratës në KRPP: 21.07.2022; Dosja e tenderit në dispozicion nga data 21.07.2022;

Sqarimi i Aplikacioneve deri me datën 10.08.2022;

Me datën 08.08.2022, kemi kërkuar informata shtese sa i përket pikës së Vlerësimit të aplikacioneve të parapara me dosjen e tenderit në fazën e parë;

Me datën 23.08.2022 kemi pranuar në mënyrë elektronike sqarimet e pyetjes shtese;

Grupin e OE Alb-Architect Sh.P.K. ka dorëzuar sipas Afatit aplikacionin që ka qene me datën 31.08.2022 koha 14:00:00, në vendin: Ofertat dorëzohen në mënyrë elektronike përmes platformës së E-Prokurimit; Consortium ALB-Architect shpk; Infra-Plus sh.p.k.; Instituti i Shkencës dhe i Teknologjisë

INSI; NOVUS shpk; Chapman Taylor LLP; Isa Kastrati NR.I, 10000, Prishtinë, është kualifikuar dhe ka pranuar dosjen me datën 08.12.2022;

Me datën 13.12.2022, kemi ngarkuar ne sistem formularin për informata shtese sa i përket pikës së Vlerësimit të propozimeve teknike të parapara me dosjen e tenderit në fazën e dytë dhe të njëjtën kërkesë e kemi dërguar edhe ne email adresën e zyrtarit të prokurimit si dhe email -adresën zyrtare të prokurimit të autoritetit kontraktues;

Me datën 28.12.2022, kemi përsëritur kërkesën për informata shtese lidhur me pikën së Vlerësimit të propozimeve teknike të parapara me dosjen e tenderit për fazën e dytë; për çka nuk kemi marrë përgjigje fare lidhur me pyetjet e parashtruara. Respektivisht me vendimin e datës 16.01.2023, për kërkesën e ri -shqyrtimit e potencon përgjigjen për kërkesën e datës 28.12.2023, ku e thekson se është pas afati konkretisht të datës 19.12.2023. Me datën 13.01.2023, paraqesim kërkesën për rishqyrtim.

Me datën 16.01.2023, pranojmë vendimin me të cilën hedhet si e jashtë ligjshme kërkesa për rishqyrtim.

Me datën 16.01.2023 e ridërgojmë kërkesën për rishqyrtim teknikisht të kompletuar, mirëpo AK nuk e shqyrton fare duke aluduar që është e jashtë afati dhe është e trajtume kërkesa e 13.01.2023.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETËNDIMET ANKIMORE TË OE “Alb -Architect ” SH.P.K, Prishtinë

Dispozitat e shkelura dhe pikat e ankesës.

Neni 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve i LPP-së

LIGJ Për Procedurën e Përgjithshme Administrative Neni 81 Llogaritja e afateve i LPP-së

Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë i LPP-së

Neni 27 Dosja e Tenderit i LPP-së

Neni 33 Procedurat e hapura dhe të kufizuara i LPP-së

Neni 51 Njoftimi i Kritereve të Përzgjedhjes i LPP-së

Neni 52 Njoftimi i kritereve për dhënien e kontratës

Neni 53 Sigurimi i informatave shtesë për kandidatët dhe tenderuesit

Neni 56 Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Grupi i OE Alb-Architect Sh.P.K pretendon se AK i ka shkelur këto dispozita të LPP (Ligji Nr. 04IL-042 PER PROKURIMIN PUBLIK TE REPUBLIKES SE KOSOVES, I ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092) dhe të Rregullore 001.2022 për Prokurimin Publik

Neni 108/A

Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

5. Nëse aplikimi nuk përmban disa nga informacionet referuar në paragrafin 4 të këtij neni, autoriteti kontraktues do të kërkojë nga ankuesi që të plotësojë kërkesën e tij Brenda një periudhe jo më të gjatë se dy (2) ditë nga marrja e kërkesës. Nëse parashtruesi i ankesës nuk vepron sipas kërkesës së lartpërmendur, kërkesa për rishikim do të refuzohet si e paplotë.

Me rastin e nxjerrjes së vendimit lidhur me kërkesën për rishqyrtim AK ka vepruar në kundërshtim

me paragrafin 5 te nenit 108A te LPP-se

LIGJ PËR PROCEDURËN E PËRGJITHSHME ADMINISTRATIVE

Neni 81 Llogaritja e afateve

4. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk do të pengojnë fillimin dhe ecjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie të shtunën, të dielën apo një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen menjëherë pas saj.

AK ka bere shkelje te paragrafit 4 të nenit 81 te Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me rastin e mos shqyrtimit te kërkesës për rishqyrtim te dërguar me datën 16.01.2023, pasi qe ne dosje theksohet se mund te parashtrohet kërkesa për rishqyrtim 5 dite para dorëzimit te dosjeve, respektivisht para datës 19.01.2023, qe i bie dita e fundit për dorëzim 14.01.2023 (dite e shtune) sipas dispozitave te nenit te larte cekur ky afat është dashtë te zgjatet deri ne ditën e hëne respektivisht 16.01.2023.

Neni 72

Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

1. Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati te caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës.

AK ka bere shkelje te këtij neni duke mos ofruar informatat shtese - sqarimet e kërkuara me datën 13.12.2022, respektivisht informata shtese sa i përket pikës se Vlerësimit te propozimeve teknike te parapara me dosjen e tenderit ne fazën e dyte, te njëjtën kërkesë e kemi përsëritur me datën 28.12.2022. Ne arsyetimin e vendimit lidhur me refuzimin e kërkesës për rishqyrtim e potencon se kërkesa për informata shtese e datës 28.12.2022 është e paraqitur jashtë afateve respektivisht te datës 19.12.2022, Zyrtari kompetent ne kuadër te AK me vetëdije e anashkalon apo e kamuflon shkeljen ligjore qe e ka bere me rastin e mos trajtimit dhe përgjegjësisë se kërkesës 13.12.2022.

Neni 27

Dosja e Tenderit

Përveç siç parashihet në paragrafin 2. të këtij neni autoriteti kontraktues do të përpiloj një dosje të tenderit që ofron informatat përkatëse lidhur me kontratën në fjalë, duke përfshirë të gjitha termet dhe kushtet aterial të saj, procedurat e zbatueshme të prokurimit, çfarëdo kërkesë të aplikueshme të përshtatshmërisë ose ndonjë kriter të përzgjedhjes, (AK ka dështuar ne hartimin e Dosjes se tenderit për fazën e pare respektivisht ne kriteret për vlerësimin e aplikacioneve duke parapare te njëjtat edhe ne dosjen e tenderit për fazën e dyte respektivisht ne kriteret për vlerësimin e propozimit teknik) procedurat e ankesës si dhe informatat e tjera përkatëse siç kërkohen nga ky ligj ose siç i sheh të domosdoshme autoriteti kontraktues. Autoriteti kontraktues duhet të përcaktojë në dosjen e tenderit, specifikimet teknike të zbatueshme dhe, aty ku është e përshtatshme, kërkesat ekzekutuese, mundësinë e varianteve dhe informatat lidhur me nënkontraktimin në pajtim me nenet 28, 29, 30 dhe 31 të këtij ligji.

Neni 33

Procedurat e hapura dhe të kufizuara

AK ka vepruar ne kundërshtim me paragrafin 3 te këtij neni kur i ka hartuar ose parapare kriteret e përzgjedhjes identike ne te dy fazat, ne si Grupi i OE "Alb-Architect" Sh.P.K kemi paraqite kërkesë për sqarim me njoftim që këto kriteret te përdorura në fazën e parë janë në kundërshtim me LPP, sepse nga praktika dhe LPP janë për fazën e dytë, fatkeqësisht AK nuk e merr parasysh kërkesën me sqarim parasysh - për bazë

. Ky paragraf e parasheh si ne vijim:

3. Pas pranimit të kërkesës për të marrë pjesë, autoriteti kontraktues do të ftojë me shkrim që të parashtrojnë tenderin ose propozimin kandidatët të cilët përmbushin kriteret e përzgjedhjes të caktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit në përputhshmëri me nenin 51 të këtij ligji. Kandidatët që nuk përzgjidhen në këtë mënyrë eliminohen nga pjesëmarrja e mëtutjeshme.

Neni 51

Njoftimi i Kriterëve të Përzgjedhjes

2. Autoriteti kontraktues duhet: (i) të përcaktojë në njoftimin e kontratës, aq sa është e mundshme, të gjitha dokumentet dhe informatat e tjera që operatorët e interesuar ekonomik duhet të dorëzojnë së bashku me tenderin apo kërkesën për pjesëmarrje; dhe (ii) të përcaktojë në tërësi në dosjen e tenderit, të gjitha dokumentet dhe informatat në fjalë. Të gjitha këto kërkesa për dokumente dhe informata do të kufizohen vetëm në aq dokumente dhe informata sa është e nevojshme për ti lejuar autoritetit kontraktues që të verifikojë se operatori përkatës ekonomik: (i) nuk konsiderohet i papërshtatshëm sipas nenit 65 të këtij ligji, dhe (ii) nëse aplikohet, i përmbush kriteret minimale të përzgjedhjes të saktësuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Në asnjë rast njoftimi i kontratës ose dosja e tenderit nuk do të kërkojnë nga operatori i interesuar ekonomik që të dorëzojë dokumente ose informata që nuk kërkojnë ose nuk janë në përputhshmëri me nenet 65-70 të këtij ligji.

Neni 52

Njoftimi i kriterëve për dhënien e kontratës

1. Autoriteti kontraktues në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit do të specifikoj kriteret që do të përdoren për dhënie të kontratës. Kriteret duhet të jenë ose çmimi më i ulët ose tenderi ekonomikisht më i favorshëm.

3. Vetëm kriteret e matshme dhe të cilat paraprakisht janë përcaktuar në dosjen e tenderit mund të shfrytëzohen për vlerësim. Autoriteti kontraktues mund të përdorë vetëm kriteret që janë relevante në mënyrë direkte me lëndën e kontratës. Kriteret të tilla janë por nuk kufizohen në lidhje me: cilësinë, çmimin, meritat teknike, estetike, dhe karakteristikat funksionale, karakteristikat e mjedisit, shpenzimet rrjedhëse, efektiviteti i koston, shërbimet e pas-shitjes dhe asistencë teknike.

4. Autoriteti kontraktues duhet të sigurojë që të bëjë një dallim të qartë në mes kriterëve të paragrafit 3. të këtij neni dhe kriterëve të përzgjedhjes në lidhje me aftësitë e përgjithshme profesionale, financiare dhe teknike të themeluara në bazë të nenit 51 të këtij ligji dhe se nuk ka përsëritje të këtyre dy kategorive të kriterëve.

AK ka bere shkelje flagrante dhe te qëllimshme paragrafin 4, te nenit 52 te LPP, as një periudhe nuk ka shpreh interesimin e evitimit te kësaj shkelje edhe pse ne në vazhdimësi ne përputhje me afatet ligjore kemi shpreh pakënaqësitë respektivisht shkeljen.

Një shkelje e tille do te kërkohej te veprohet nga KRPP sipas pikës II te nenit 43.8 te Rregullorja 001/2022 për Prokurimin Publik i cili e rregullon si ne vijim : Procedura e prokurimit para hapjes së

ofertave mund të anulohet për arsye të mëposhtme: i. nëse AK gjatë përgatitjes dhe udhëheqjes së procedurës ka përdorur gabimisht opsionin për procedurën përkatëse dhe i cili gabim me verifikim të KRPP-se është i pariparueshëm;

AK ka përdorur gabimisht në procedurën e kufizuar kriteret e vlerësimit të aplikacionit dhe Kriteret e vlerësimit të propozimeve teknike, në të dy fazat janë identike,

shihe Dosjen e Fazës së parë në pikën 22. Ku ka parapamë mënyrën e vlerësimit të Aplikacioneve:

Vlerësimi i aplikacioneve

22.3

Faktorët të cilët do të merren në konsideratë gjatë ri-ekzaminimit janë:

Faktori i cili do të merret në konsideratë gjatë ri-ekzaminimit është Vlera më e lartë e kontratave të përfunduara me sukses që e plotësojnë kriterin e kapacitetit teknik

Tabela përmbledhëse e poentimit teknik		maksimal i Poenëve teknik	vlerësimi i Poenëve teknik
I)	Përvoja specifike e Konsulentit në lidhje me angazhimin:		
	Përvoja në menaxhimin e projekteve	10	
II)	Pikët totale për kriterium (I):	10	
	Përshtatshmëria e Metodologjisë së propozuar dhe planit të punës në përgjigjen ndaj TER:		
	a) Qasja teknike dhe metodologjia:	20	
	b) Plan i punës:	20	
	c) Organizimi (organogrami):	10	
III)	d) Vlerësimi i kualitetit të (5 referencave) referencave: (Paneli vlerësues poenton nga 1-10 në bazë të 5 referencave të cilat operatori i paraqet si më reprezentativet të tijë).	10	
	Pikët totale për kriterium (II):	60	
	Kualifikimet dhe kompetencat e stafit kryesorë për angazhim:		
	a) Staf i udhëheqës (8 sektorët kryesorë, përcjellët nga Tabela III-a)	20	
	b) Staf i përkrahës (përcjellët nga Tabela III-b)	10	
(Nt)	Pikët totale për kriterium (III):	30	
	Pikët totale për kriteret teknike (I+II+III):	100	

shihë Dosjen e e Fazes se dyte ne piken 23.1. Ku e ka parapare menyren e vlersimit te propozimeve teknike :

Vlerësimi i Propozimeve Teknike	23.1	<table> <tr> <td colspan="3">Përvoja specifike e Konsulentit në lidhje me angazhimin:</td></tr> <tr> <td>Përvoja në menaxhimin e projekteve</td><td>10</td><td></td></tr> <tr> <td colspan="3">Përshtatshmëria e Metodologjisë së propozuar dhe planit të punës në përgjigjen ndaj TER:</td></tr> <tr> <td>a) Qasja teknike dhe metodologjia:</td><td>20</td><td></td></tr> <tr> <td>b) Plan i punës:</td><td>20</td><td></td></tr> <tr> <td>c) Organizimi (organogrami):</td><td>10</td><td></td></tr> <tr> <td>d) Vlerësimi i kualitetit të (5 referencave) referencave: (Paneli vlerësues poenton nga 1-10 në bazë të 5 referencave të cilat operatori i paraqet si më reprezentativet të tijë).</td><td>10</td><td></td></tr> <tr> <td>Pikët totale për kriterium (II):</td><td>70</td><td></td></tr> <tr> <td colspan="3">Kualifikimet dhe kompetencat e stafit kryesorë për angazhim:</td></tr> <tr> <td>a) Stafi udhëheqës (8 sektoret kryesore, përcjellët nga Tabela III-a)</td><td>20</td><td></td></tr> <tr> <td>b) Stafi përkrahës (përcjellët nga Tabela III-b)</td><td>10</td><td></td></tr> <tr> <td>Pikët totale për kriterium (III):</td><td>30</td><td></td></tr> <tr> <td>Pikët totale për kriteret teknike (I+II+III):</td><td>100</td><td></td></tr> </table> <p>Pikët totale për kriteret: 100 Nota teknike minimale Nt që kërkohet për të kaluar është 80 nga 100 pikë të mundshme.</p>	Përvoja specifike e Konsulentit në lidhje me angazhimin:			Përvoja në menaxhimin e projekteve	10		Përshtatshmëria e Metodologjisë së propozuar dhe planit të punës në përgjigjen ndaj TER:			a) Qasja teknike dhe metodologjia:	20		b) Plan i punës:	20		c) Organizimi (organogrami):	10		d) Vlerësimi i kualitetit të (5 referencave) referencave: (Paneli vlerësues poenton nga 1-10 në bazë të 5 referencave të cilat operatori i paraqet si më reprezentativet të tijë).	10		Pikët totale për kriterium (II):	70		Kualifikimet dhe kompetencat e stafit kryesorë për angazhim:			a) Stafi udhëheqës (8 sektoret kryesore, përcjellët nga Tabela III-a)	20		b) Stafi përkrahës (përcjellët nga Tabela III-b)	10		Pikët totale për kriterium (III):	30		Pikët totale për kriteret teknike (I+II+III):	100	
Përvoja specifike e Konsulentit në lidhje me angazhimin:																																									
Përvoja në menaxhimin e projekteve	10																																								
Përshtatshmëria e Metodologjisë së propozuar dhe planit të punës në përgjigjen ndaj TER:																																									
a) Qasja teknike dhe metodologjia:	20																																								
b) Plan i punës:	20																																								
c) Organizimi (organogrami):	10																																								
d) Vlerësimi i kualitetit të (5 referencave) referencave: (Paneli vlerësues poenton nga 1-10 në bazë të 5 referencave të cilat operatori i paraqet si më reprezentativet të tijë).	10																																								
Pikët totale për kriterium (II):	70																																								
Kualifikimet dhe kompetencat e stafit kryesorë për angazhim:																																									
a) Stafi udhëheqës (8 sektoret kryesore, përcjellët nga Tabela III-a)	20																																								
b) Stafi përkrahës (përcjellët nga Tabela III-b)	10																																								
Pikët totale për kriterium (III):	30																																								
Pikët totale për kriteret teknike (I+II+III):	100																																								

Shume qartë e thekson Rregullorja 001/2022 për Prokurimin Publik ne neni 27.10 si ne vijim: Duhet të ketë kujdes për të siguruar që kriteret minimale për kualifikim (kriteret e përzgjedhjes) nuk përdorën si kritere në procesin e dhënies së kontratës. Tenderuesit do të konsiderohen të kenë përmbushur kërkesat minimale në lidhje me kapacitetin e tyre për të performuar kontratën që do të thotë që kriteret në lidhje me përvojat paraprake dhe historikut të kompanisë nuk do të shihen si kritere në procesin e dhënies së kontratës. Sipas nenit 27.7 të Rregullorja 001/2022 për Prokurimin Publik theksohet si ne vijim: Nëse autoriteti kontraktues gjatë procedurës së prokurimit kupton që kriteret e përdorura janë të papërshtatshme për të përcaktuar tenderin ekonomikisht më të favorshëm, përmirësimi i vetëm i situatës është anulimi i procedurës dhe tenderit. Duke u bazuar ne këtë pikë ne do ti marrim të gjitha veprimet e nevojshme që kjo shkelje ligjore të përmirësohet.

Neni 53

Sigurimi i informatave shtesë për kandidatët dhe tenderuesit

Vërtetimi i dyshimeve se kjo shkelje është e qëllimshme e fakton - argumenton edhe qasja e komunikimit me OE Zyrtari i Prokurimit të AK me Grupi i OE Alb-Architect Sh.P.K, ku ne kundërshtim me paragrafin 4 të këtij neni vepron respektivisht Me datën 28.12.2022, kemi kërkuar Sqarimet shtese sipas kërkesës tonë të dërguar me datën 13.12.2022, lidhur me pikën se Vlerësimit të propozimeve teknike të parapara me dosjen e tenderit për fazën e dyte. Paragrafi 4 i këtij neni e thekson si ne vijim: Autoriteti kontraktues menjëherë do të shqyrtojë çfarëdo kërkesë të tillë për të përcaktuar nëse operatorët ekonomik kanë apo nuk kanë nevojë për informatat sqaruese ose plotësues të kërkuar në mënyrë që të përgatisin një tender të përgjegjshëm.

AK lidhur me trajtimin e kërkesave për informata shtese të datës 13.12.2023 si dhe 28.12.2023 ka vepruar ne kundërshtim me paragrafin 7 të nenit 53 të LPP-se i cili e thekson si ne vijim :

Nëse, në një aktivitet të prokurimit që përfshin përdorimin e procedurave të hapura, të kufizuara ose konkurruese me negociata, autoriteti kontraktues u jep informata sqaruese ose plotësuese operatorëve ekonomik, dhe afati në të cilin informatat e tilla jepen është më i shkurtër se dhjetë (10) ditë nga afati i caktuar për pranimin e tenderëve, autoritetit kontraktues do ti zgjatet afati i tillë për ti dhënë operatorëve ekonomik së paku dhjetë (10) ditë nga dita të cilën informatat përkatëse jepen për ti dorëzuar tenderët e tyre. Nëse një operator ekonomik ka dorëzuar një tender, operatorit të tillë ekonomik do ti lejohet që të dorëzojë një përmirësim për tenderin përkatës, por përmirësimi i tillë kufizohet vetëm në ndryshimet që janë të lidhura me informatat e tilla të arsyeshme sqaruese ose shtesë.

Neni 56

Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave

1. Të gjitha kontratat publike do të jepen, sipas procedurave të themeluara për një seleksionim të tillë, dhe përmes:

1.1. së pari, vlerësimit të tenderëve dhe kandidatëve sipas kërkesave të kualifikimit të specifikuar në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit sipas paragrafit 2. të nenit 51 të këtij ligji, dhe tenderëve sipas specifikimeve teknike të kërkuara në bazë të nenit 28 të këtij ligji;

1.2. së dyti, vlerësimi i tenderëve në përputhshmëri të kriterëve të vendosura në nenin 60 të këtij ligji;

2. Në rastin e procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, autoriteti kontraktues do t'i zgjedhë kandidatët që do të ftohen për të dorëzuar tender ose propozim, vetëm në bazë të:

2.1 kriterëve të përzgjedhjes të specifikuar në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit në përputhshmëri me paragrafin 2. të nenit 51 të këtij ligji dhe

2.2. Dokumenteve, informatave dhe/ose dëshmi mbi kualifikimet e dorëzuara nga kandidatët si përgjigje të drejtpërdrejt ndaj kërkesave të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet para kualifikuese. Kandidatët që nuk zgjidhen në këtë mënyrë eliminohen nga pjesëmarrja e mëtutjeshme.

25.4 Gjatë përcaktimit të kërkesave minimale për kualifikim, AK do ti kushtoj rëndësi të veçantë zhvillimit të OE dhe do të formulojë kërkesat minimale të kualifikimit në mënyrë që nuk përjashton OE të themeluar rishtazi të cilët posedojnë aftësi të arsyeshme dhe të mjaftueshme ekonomike, financiare dhe/ose teknike. "Te arsyeshme dhe të mjaftueshme" do të nënkuptojnë në lidhje me:

a. vlerën e parashikuar të kontratës, dhe

b. përdorim të drejtë të fondeve publike.

25.5 Kriteret e përzgjedhjes:

a. në asnjë mënyrë nuk mund të përdoren si kriter të dhënies së kontratës

- b. nuk mund të kenë peshë të caktuara;
c. ato janë kërkesa të vlerësimit Kalon / Nuk kalon

Shume qarte e potencon Rregullorja 001/2022 për Prokurimin Publik se cilat janë kriteret para kualifikuese andaj, ndaj me qellim të ruajtjes se ligjshmërisë ne kërkojmë të ndërmerrni veprimet sipas legjislacionit në fuqi për raste të tilla.

Me qellim të efikasitetit të procesit në kërkojmë nga OSHP që të aprovon Ankesën tonë, me të cilën e obligon AK që në rastin konkret ti shfrytëzoj metodologjinë e kërkuar dhe të dorëzuara nga OE në fazën e parë, pasi që në këtë mënyrë e eliminon dyshimin që kjo është bërë me qëllime diskriminimit apo favorizimit të ndonjë OE.

Nëse kjo nuk është e mundur të bëhet anulimi i procedurës dhe tenderit, pasi që kemi të bëja me rastin e paraparë me nenin 27.7 të Rregullorja 001/2022 për Prokurimin Publik theksohet si në vijim Nëse autoriteti kontraktues gjatë procedurës së prokurimit kupton që kriteret e përdorura janë të papërshtatshme për të përcaktuar tenderin ekonomikisht më të favorshëm, përmirësimi i vetëm i situatës është anulimi i procedurës dhe tenderit.

Dëmet materiale

Demet materiale janë te shumta dhe pas një ekspertize financiare do të caktohen saktë . Vlen të theksohen disa shpenzime të bëra për veprimet e kompanisë ne kontraktimin për angazhim të stafit dhe mjeteve shtese për këtë projekt, atëherë konsiderojmë që kemi humbje të mëdha materiale, prandaj inkurajojmë OSHP-en që të aprovoj ankesën ton.

VLERËSIMI I PROPOZIMEVE TEKNIKE

Vlerësimi i Propozimeve Teknike	23.1	<table> <tr> <td colspan="3">Përvoja specifike e Konsulentit në lidhje me angazhimin:</td></tr> <tr> <td>Përvoja në menaxhimin e projekteve</td><td>10</td><td></td></tr> <tr> <td colspan="3">Përshtatshmëria e Metodologjisë së propozuar dhe planit të punës në përgjigjen ndaj TER:</td></tr> <tr> <td>a) Qasja teknike dhe metodologjia:</td><td>20</td><td></td></tr> <tr> <td>b) Plan i punës:</td><td>20</td><td></td></tr> <tr> <td>c) Organizimi (organogrami):</td><td>10</td><td></td></tr> <tr> <td>d) Vlerësimi i kualitetit të (5 referencave) referencave: (Paneli vlerësues poenton nga 1-10 në bazë të 5 referencave të cilat operatori i paraqet si më reprezentativet të tijë).</td><td>10</td><td></td></tr> <tr> <td>Pikët totale për kriterium (II):</td><td>70</td><td></td></tr> <tr> <td colspan="3">Kualifikimet dhe kompetencat e stafit kryesorë për angazhim:</td></tr> <tr> <td>a) Stafi udhëheqës (8 sektoret kryesore, përcjellët nga Tabela III-a)</td><td>20</td><td></td></tr> <tr> <td>b) Stafi përkrahës (përcjellët nga Tabela III-b)</td><td>10</td><td></td></tr> <tr> <td>Pikët totale për kriterium (III):</td><td>30</td><td></td></tr> <tr> <td>Pikët totale për kriteret teknike (I+II+III):</td><td>100</td><td></td></tr> <tr> <td colspan="3"> Pikët totale për kriteret: 100 Nota teknike minimale Nt që kërkohet për të kaluar është 80 nga 100 pikë të mundshme. </td></tr> </table>	Përvoja specifike e Konsulentit në lidhje me angazhimin:			Përvoja në menaxhimin e projekteve	10		Përshtatshmëria e Metodologjisë së propozuar dhe planit të punës në përgjigjen ndaj TER:			a) Qasja teknike dhe metodologjia:	20		b) Plan i punës:	20		c) Organizimi (organogrami):	10		d) Vlerësimi i kualitetit të (5 referencave) referencave: (Paneli vlerësues poenton nga 1-10 në bazë të 5 referencave të cilat operatori i paraqet si më reprezentativet të tijë).	10		Pikët totale për kriterium (II):	70		Kualifikimet dhe kompetencat e stafit kryesorë për angazhim:			a) Stafi udhëheqës (8 sektoret kryesore, përcjellët nga Tabela III-a)	20		b) Stafi përkrahës (përcjellët nga Tabela III-b)	10		Pikët totale për kriterium (III):	30		Pikët totale për kriteret teknike (I+II+III):	100		Pikët totale për kriteret: 100 Nota teknike minimale Nt që kërkohet për të kaluar është 80 nga 100 pikë të mundshme.		
Përvoja specifike e Konsulentit në lidhje me angazhimin:																																												
Përvoja në menaxhimin e projekteve	10																																											
Përshtatshmëria e Metodologjisë së propozuar dhe planit të punës në përgjigjen ndaj TER:																																												
a) Qasja teknike dhe metodologjia:	20																																											
b) Plan i punës:	20																																											
c) Organizimi (organogrami):	10																																											
d) Vlerësimi i kualitetit të (5 referencave) referencave: (Paneli vlerësues poenton nga 1-10 në bazë të 5 referencave të cilat operatori i paraqet si më reprezentativet të tijë).	10																																											
Pikët totale për kriterium (II):	70																																											
Kualifikimet dhe kompetencat e stafit kryesorë për angazhim:																																												
a) Stafi udhëheqës (8 sektoret kryesore, përcjellët nga Tabela III-a)	20																																											
b) Stafi përkrahës (përcjellët nga Tabela III-b)	10																																											
Pikët totale për kriterium (III):	30																																											
Pikët totale për kriteret teknike (I+II+III):	100																																											
Pikët totale për kriteret: 100 Nota teknike minimale Nt që kërkohet për të kaluar është 80 nga 100 pikë të mundshme.																																												

Raporti i Ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën numër PSH. Nr. 44/23, të "Alb - Architect" SH.P.K, Prishtinë, pjesëmarrës në ftesën për ofertë lidhur me aktivitetin e prokurimit "Konsulencë për themelimin e Shërbimit të Arkitektit të Kryeqytetit për nevojat e Komunës së Prishtinës " me numër të prokurimit: 616-22-7431-3-1-2 iniciuar nga AK/ – KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS,,

Aneksi 1. TERMAT E REFERENCËS (TER)

HISTORIKU	
1.1 Shteti përfitues	Kosova
1.2 Autoriteti Kontraktues	Komuna e Prishtinës
1.3 Historiku përkatës i vendit	<p>Misioni & Vizioni</p> <p>Prishtina e së ardhmes është qytet me shërbime efikase e cilësore të cilat janë në funksion të mirëqenies së përgjithshme të qytetarëve të saj.</p> <p>Qytet me planifikim urban e hapësinor të mirëfilltë, i cili e bën kryeqytetin qendër të sigurt për një jetë të begatshme socio-ekonomike, kulturore, arsimore, sportive, dhe duke siguruar mirëqenie dhe cilësi të jetës për qytetarët e komunës së Prishtinës.</p> <p>Qytet me model të qeverisjes efikase dhe transparente, dhe si i tillë, të shërbejë si model edhe për qeverisje në komunat tjera në Kosovë, duke ndikuar kështu në rritjen e mirëqenies për tërë qytetarët e Kosovës.</p> <p>Komuna e Prishtinës shtrihet në sipërfaqe prej 572 km²</p> <p>Komuna e Prishtinës i ka gjithsej 48 fshatra.</p> <p>Në Komunën e Prishtinës ekzistojnë edhe 57 prona shoqërore me 143 biznese shoqërore. Kështu, numri i përgjithshëm i biznesit të regjistruar në Komunën e Prishtinës është 8.735 biznese më 75.089 punëtorë.</p> <p>Në Komune gravitojnë një numër i papërcaktuar i punonjësve/të punësuarve që çdo ditë vijnë në Kryeqytet dhe shkojnë në fund të ditës.</p> <p>Shërbimet e komunës, drejtoritë të cilat direkt ose në mënyrë të tërthortë do të përfitojnë nga konsulenca, kryejnë këto shërbime dhe kanë kompetenca si janë të përshkruara më poshtë:</p> <p>Drejtoria e Urbanizmit</p> <p>Përgatit dhe ofron informacione bazë dhe dokumente për përgatitjen, miratimin e dokumentacionit teknik për leje të ndërtimit;</p> <p>Propozon dhe zbaton aktet ligjore nga lëmi i planifikimit hapësinor; Planit zhvillimor të Komunës, Planit zhvillimor urban, Planit rregullues urban, si dhe rregullativën nga lëmi i ndërtimeve investive dhe mbrojtja e mjedisit;</p> <p>Përcakton kushtet e ndërtimit, në harmoni me Ligjin e ndërtimit,</p> <p>Propozon dhe miraton kriteret për vendosjen e objekteve të përkohshme, pajisjeve dhe elementeve mikro – urbane në territorin e qytetit dhe të komunës;</p> <p>Merret me hartimin e projekt rregullorëve, ekspertizave analitike, veprimtarive të tjera në fushat e caktuara të planifikimit hapësinor dhe urban, mbrojtja e mjedisit dhe lëmi i ndërtimeve;</p> <p>Propozon dhe zbaton programin për hapësirën e komunës;</p> <p>Lëshon leje të ndërtimit për të gjitha llojet e objekteve që përcakton ligji në kompetencë të Komunës;</p> <p>Jep pëlqime për ndërtimin e objekteve të rëndësisë lokale dhe zhvillimeve të tjera.</p> <p>Organizon dhe trajnon grupet profesionale dhe kapacitetet njerëzore për procedurën e legalizimit;</p> <p>Organizon dhe cakton grupin profesional për pranimin dhe shqyrtimin e kërkesave (dokumentacioneve) për legalizim;</p>

Raporti i Ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën numër PSH. Nr. 44/23, të "Alb -Architect " SH.P.K, Prishtinë, pjesëmarrës në ftesën për ofertë lidhur me aktivitetin e prokurimit "Konsulencë për themelimin e Shërbimit të Arkitektit të Kryeqytetit për nevojat e Komunës së Prishtinës " me numër të prokurimit: 616-22-7431-3-1-2 iniciuar nga AK/ – KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS,,

	<p>Organizon dhe cakton grupin profesional për vlerësimin e objekteve të ndërtuara pa leje;</p> <p>Konstaton dhe përcjell informatat për objektet e ndërtuara në mospërputhje me ligjet ndërtimore, standardet, dokumentacionet urbanistike në fuqi, dhe veçmas me rregulloren dhe Manualin për legalizim;</p> <p>Kontrollon dokumentacionin teknik në harmoni me ligjet ndërtimore, standardet, dokumentacionet urbanistike në fuqi, si dhe me rregulloren dhe Manualin për legalizim;</p> <p>Shqyrton programe për ndërtimin e infrastrukturës dhe objekteve kapitale në tërësi të hapësinore ilegale;</p> <p>Bashkëpunon me subjektet përkatëse komunale në fushën e rregullimit të tokës ndërtimore dhe me të gjitha subjektet tjera përkatëse;</p> <p>Koordinon dhe kryen punët procedurale nga lëmi i ndërtimeve ilegale;</p> <p>Lëshon vendime dhe vërtetime për gjendjen e objekteve ekzistuese;</p> <p>Konstaton dhe përcjell informatat për objektet e ndërtuara në mospërputhje me ligjet ndërtimore, standardet dhe dokumentacionet urbanistike në fuqi;</p> <p>Jep leje për përdorimin e objekteve të përfunduara;</p> <p>Bashkëpunon me subjektet përkatëse komunale në fushën e rregullimit të tokës ndërtimore;</p> <p>Propozon krijimin e zonave të tokës së ndërtimit dhe përpunon lokacionet për dhënie të tokës në shfrytëzim;</p> <p>Kryen edhe punë të tjera, në përputhje me ligjet e aplikueshme në kuadër të fushë veprimtarisë së Drejtorisë.</p> <p><u>Spektori i Urbanizmit</u> është pjesë e Drejtorisë së Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit. Spektori është përgjegjës për lëshimin e kushteve dhe lejeve të ndërtimit në Komunën e Prishtinës, në përputhje me dokumente të vlefshme të Planifikimit Hapësinor dhe për Ndërtim.</p> <p>Aktet që lëshohen nga ky sektor:</p> <ul style="list-style-type: none"> <input type="checkbox"/> Kushtet e ndërtimit, <input type="checkbox"/> Lejet e ndërtimit, <input type="checkbox"/> Lejet për ndërrim të destinimit, <input type="checkbox"/> Pëlqimet e ndryshme sa i përket ndërtimeve. <input type="checkbox"/> Puna e Spektorit të urbanizmit është transparente dhe e qasshme në çdo kohë nëpërmjet tabelës së Sistemit të vrojtimit për leje ndërtimit. <p><u>Spektori i ndërtimit</u> është pjesë e Drejtorisë së Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit. Spektori është përgjegjës për mbikëqyrjen e realizimit të ndërtimeve nga fondet publike, kontrollimin e fazave sa i përket ndërtimit lëshimin e lejeve për infrastrukturë, në përputhje me rregullativën ligjore për ndërtim dhe dokumentet e të vlefshme të Planifikimit Hapësinor si dhe për realizimin e pranimin teknik të ndërtimeve.</p> <ul style="list-style-type: none"> <input type="checkbox"/> Aktet që lëshohen nga ky sektor: <input type="checkbox"/> Leje për infrastrukturë, <input type="checkbox"/> Pëlqim për kryerje të punëve infrastrukturore. <p><u>Spektori i Mbrojtjes së Mjedisit</u> është pjesë e Drejtorisë së Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit. Spektori monitoron zhvillimin dhe zbatimin e dokumentacionit në fushën e mbrojtjes së mjedisit (trajtimin e menaxhimin e mbeturinave, ruajtjen e cilësisë së ajrit, mbrojtje nga zhurma, mbrojtjen e natyrës, etj).</p>
--	--

	<p>Aktivitetet profesionale për mbrojtjen e mjedisit në veçanti përfshijnë grumbullimin, regjistrimin, vlerësimin e të dhëna për natyrën dhe mjedisin, si dhe bashkëpunimi me organet kompetente qeveritare, qeveritë rajonale dhe lokale, institucionet dhe organizatat që kanë të bëjnë me promovimin dhe mbrojtjen e mjedisit dhe natyrës.</p> <p>Merr pjesë në përgatitjen e dokumenteve të planifikimit hapësinor në segmentin në lidhje me natyrën dhe mjedisin. Në mënyrë që të krijojë një sistemi monitorues dhe informacionit.</p> <p>Akti që lëshohet nga ky sektor:</p> <p><input type="checkbox"/> Leje mjedisore</p> <p><u>Sektori i Legalizimit</u> vepron në kuadër të Drejtorisë së Urbanizmit dhe kryen detyra që kanë të bëjnë me trajtimin e ndërtimeve pa leje sipas Ligjit për Trajtimin e ndërtimeve pa leje dhe akteve të tjera nënligjore që rregullojnë këtë fushë.</p> <p>Portal i qasjes online në kërkesa për leje ndërtimi e Leja</p> <p>Platforma elektronike e Leja mundëson lehtësimin e procedurave të aplikimit dhe trajtimit të kërkesave të parashtruara nga kërkuessit dhe shqyrtuar nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës.</p> <p>Drejtoria e Kadastrit</p> <p>Është përgjegjëse për zhvillimin dhe organizimin e kapaciteteve kadastrale, rrjetin referues homogjen, rikonstruimin e informatave kadastrale në formë digjitale, modelin e sistemit informativ për tokën dhe pronën</p> <p>Ofron shërbime profesionale dhe shërbime të tjera për subjekte të interesuar;</p> <p>Përmirëson transferimin e tokës, menaxhimin e tokës shtetërore dhe efikasitetin në tatimin e tokave;</p> <p>Planifikon rrjetin me pika të reja kontrolluese dhe themelon pika të reja kontrolluese;</p> <p>Digjitalizon pikat poligonale dhe trigonometrike, vektorizimin e planeve të skanuara (ngastrave dhe zonave kadastrale);</p> <p>Azhurnon pjesën grafike, në bazë të dokumenteve dhe matjeve të reja dhe i transformon me parametrat e dhëna për transformim;</p> <p>Ofron shërbime rreth mirëmbajtjes dhe klasifikimit të kulturave të tokës;</p> <p>Ofron shërbime për ndarjen e ngastrave dhe shënimin e kufijve në rastet e shpronësimeve;</p> <p>Kryen punë profesionale, në fushën e gjeodezisë (ndryshimet e bëra gjatë matjeve-bartjes së tyre në programin e gjeodezisë);</p> <p>Ofron shërbime për shënimet e digjitalizuara (dhënien e koordinatave në terren);</p> <p>Kontrollon rrjetet dhe matjet gjeodezike;</p> <p>Incizon sipërfaqet e ndërtesave dhe pjesëve të tyre, objektet nëntokësore dhe mbitokësore dhe i përpunon skicat;</p> <p>Regjistron pronën e paluajtshme dhe tokën komunale;</p> <p>Zhvillon procedurën e regjistrimit, në përputhje me ligjet, sipas detyrës zyrtare dhe kërkesave të palëve;</p> <p>Korrigjon regjistrin (RDPP) sipas procedurave dhe dispozitave ligjore në fuqi;</p> <p>Azhurnon e regjistrin e pronën, në bazë të dokumenteve të verifikuara dhe shënimeve të tjera nga dokumentacioni arkivor si dhe regjistrin të ndërrimeve të mjeteve nga terreni;</p> <p>Zbaton procedurat rreth transaksioneve të pronës publike në RDPP;</p>
--	---

	<p>Shqyrton dhe zhvillon procedurat administrative për rikthimin e paluajtshmërisë ish-pronarit, evidenton dhe shlyen masat e përkohshme sipas aktvendimit të gjykatës kompetente;</p> <p>Udhëheq me kadastrën etazhore të banesave, ndërtesave, si dhe ngastrat kadastrale në të cilat janë të ndërtuara banesat;</p> <p>Regjistron dhe çregjistron hipotekat;</p> <p>Merr vendime mbi regjistrimin e servituteve, barrën tatimore, ngastrat e tatimit në pronë dhe shënimet lidhur me dorëzanitë;</p> <p>Lëshon certifikata për patundshmëri, sipas kërkesave;</p> <p>Mirëmban, korrigjon dhe harmonizon evidencat e vendbanimeve, fshatrave, shesheve, rrugëve dhe numrat e objekteve dhe ndërtesave;</p> <p>Nxjerr vendime për miratim ose refuzim të kërkesave;</p> <p>Nxjerr konkluzione për plotësimin e kërkesave të pakompletuara;</p> <p>Përmirësimi i transferimit të tokës, menaxhimi i tokës shtetërore dhe efikasiteti në tatimin e tokave;</p> <p>Kryen edhe punë të tjera, në bazë të ligjeve të aplikueshme në kuadër të fushë veprimtarisë së Drejtorisë.</p> <p>Me qëllim të ushtrimit të funksioneve të përcaktuara me dispozitat ligjore në fuqi, Drejtoria e Kadastrit, është e organizuar në këta sektorë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Sektori i Kadastrit; 2. Sektori i Gjeodezisë. <p>Drejtoria e Inspektionit</p> <p>Mbikëqyrë dhe inspekton të gjitha dukuritë negative që hasen në territorin e komunës së Prishtinës;</p> <p>Mbikëqyrë dhe verifikon nëse shtetasit në administrim të pasurisë së tyre, zbatojnë ose plotësojnë kërkesat e akteve komunale;</p> <p>Të ndalojë uzurpimin e paligjshëm të trojeve, ndërtesave dhe objekteve të komunës si dhe të organizojë lirimimin e tyre;</p> <p>Përcjellë procesin e ndërtimeve, ndryshimeve, shndërrimeve, si dhe rrënimit të objekteve;</p> <p>Përcjellë rrjetin e ujësjellësit, kyçjet pa leje në rrjet, si dhe parandalimin e keqpërdorimit të ujit të pijshëm;</p> <p>Mbikëqyrë kyçjet ilegale në rrjetin e kanalizimit publik, ndërhyrjen (prerjen) e rrugëve publike pa leje, të trotuareve dhe të sipërfaqeve tjera publike;</p> <p>Mbikëqyrë mirëmbajtjen e rrugëve, trotuareve, shesheve, parqeve, varrezave, tregut të gjelbër, terreneve sportive dhe sipërfaqeve të tjera publike;</p> <p>Mbikëqyrë procesin e prodhimit, përpunimit, ruajtjes, transportit – bartjes së ushqimit, pajisjeve dhe veglave;</p> <p>Mbikëqyrë ujin, objektet si dhe aparatet për furnizimin me ujë të pijshëm;</p> <p>Është përgjegjëse për konfiskimin e mallit të dyshimtë, të prishur që paraqet rrezik për shëndetin publik dhe asgjësimin e tij, në përputhje me rregullat dhe procedurat në fuqi;</p> <p>Inspekton hapësirat afariste, objektet, pajisjet dhe mjetet e prodhimit për punimin dhe qarkullimin që e produkteve bujqësore;</p> <p>Inspekton veprimtaritë industriale që mund të shkaktojnë ndotjen e ajrit, dheut dhe ujit, që shkaktohen;</p> <p>Inspekton dokumentacionin teknik (projektet e ndërtimit, lejet e ndërtimit, inspektimin final të vend ndërtimit);</p>
--	---

	<p>Inspekton procesin e ndërtimit në të gjitha fazat dhe verifikon përputhshmërinë me dokumentacionin ndërtimor;</p> <p>Sigurohet që janë ndërmarrë masat adekuate të sigurisë së objekteve në ndërtim, objekteve të tjera përreth dhe komunikacionit;</p> <p>Vërteton saktësinë dhe origjinalitetin e dokumentacionit, të cilat investitori duhet t'i ketë në dispozicion në vend ndërtim, në përputhshmëri me ligjin;</p> <p>Përpilon procesverbalet për gjendjen e punimeve në vend ndërtim, duke vlerësuar respektimin e kushteve të përcaktuara për ndërtim, cilësinë e punimeve dhe të materialit ndërtimor;</p> <p>Merr vendime për ndërprerjen e ndërtimit, në rast tjetër mospërputhjeve me kërkesat e lejes ndërtimore;</p> <p>Marr vendime për rrënimin e objekteve të ndërtimit, në rast të mospërputhjes me kërkesat e lejes ndërtimore.</p> <p>Kujdeset që gjendja shëndetësore të personave të cilët për shkak të veprimtarisë së tyre mund të rrezikojnë shëndetin e popullatës;</p> <p>Mbikëqyrë përmbushjen e kushteve sanitare-teknike dhe higjienike në procesin e dhënies së lejes ndërtimore, në përputhje me ligjin në fuqi;</p> <p>Në përputhje me ligjin, merr masa mbrojtëse për shëndetin e popullatës nga veprimi i dëmshëm i produkteve të duhanit, dhe i pirjes së duhanit;</p> <p>Mbikëqyrë zbatimin e dispozitave që kanë të bëjnë me kontrollimin shëndetësor të kafshëve, gjërave ushqimore me prejardhje nga kafshët, mishit dhe prodhimeve të mishit, objekteve dhe pajisjeve për prodhimin e mishit, objekteve dhe pajisjeve për prodhimin, ruajtjen dhe shitjen e mishit;</p> <p>Mbikëqyrë dhe kontrollon procesin e para therjes, therjes dhe pas therjes së kafshëve në përputhje me ligjet në fuqi;</p> <p>Mbikëqyrë ekspozimin e mallrave jashtë lokaleve afariste, ndalimin e shfrytëzimit (vendosjes) pa leje të hapësirave publike, vënien e mbishkrimeve, reklamave, vitrinave, objekteve publike dhe higjienike, hoteliere, sallave publike;</p> <p>Mbikëqyrë zbatimin e dispozitave për vënien e panove dhe të reklamave të të gjitha llojeve;</p> <p>Mbikëqyrë zbatimin e dispozitave ligjore nga lëmi i komunikacionit dhe të mjeteve motorike në qarkullimin publik;</p> <p>Mbikëqyrë, kontrollon dhe marr masa të parapara ligjore, kundër transportuesve ilegalë dhe të atyre që nuk e respektojnë orarin e caktuar nga organi kompetent;</p> <p>Inspekton rrugët publike në të cilat kryhen punimet rrugore gjatë projektimit, ndërtimit, rikonstruktimit, mirëmbajtjes sinjalizimit horizontal dhe vertikal;</p> <p>Inspekton zbatimin e planit të menaxhimit të sigurisë së përgjithshme rrugore brenda brezit të sigurisë rrugore (projektimit, ndërtimit, rikonstruktimit, mirëmbajtjes, sinjalistikës rrugore);</p> <p>Inspekton transportin publik urban, urban periferik dhe të mallrave;</p> <p>Inspekton transportin e mbingarkesave boshtore dhe atë jashtë gabariteve të transportuesve të ndryshëm;</p> <p>Mbikëqyrë zbatimin e dispozitave ligjore për zonat e mbrojtura të natyrës nga kontaminimi, mbeturinat dhe materiet rrezikshme;</p> <p>Inspekton aktivitetet që shkaktojnë çrregullime të përgjithshme në ambient dhe identifikon palën përgjegjëse, e cila ka shkaktuar çrregullime;</p> <p>Mbikëqyrë zbatimin e dispozitave ligjore që mbrojnë ujin, ajrin, dheun nga ndotja;</p>
--	---

	<p>Mbikëqyrë zbatimin e dispozitave ligjore për menaxhimin dhe eksplotimin e resurseve natyrore (prejra e pyjeve, nxjerrja e rërës nëpër lumenj etj.) nga aspekti i mbrojtjes së ambientit;</p> <p>Inspekton punën e gurthyesve;</p> <p>Monitoron shërbimet publike komunale, që kanë të bëjnë me mbrojtjen e ambientit (menaxhimin e mbeturinave, kanalizimit, ujit dhe shërbimeve tjera publike për parandalimin e ndotjes së ambientit);</p> <p>Është përgjegjëse për planifikimin lokal të ambientit, masat për konservimin e natyrës, masat tjera mbrojtëse ndaj zhurmës, trafikut etj;</p> <p>Sigurohet dhe ndërmerr masa që toka bujqësore të mos shfrytëzohet për qëllime jo bujqësore,</p> <p>Mbikëqyrë ndarjen e tokës bujqësore nga ndotësit dhe urdhëron marrjen dhe zbatimin e masave, për mbrojtje nga zjarri në rastet e djegies nga shfrytëzuesi apo pronari i tokës bujqësore;</p> <p>Zbaton masat agroteknike për ruajtjen dhe mbrojtjen e të mbjellave dhe të kulturave tjera;</p> <p>Kryen edhe punë të tjera, në përputhje me ligjet e aplikueshme në kuadër të fushë veprimtarisë së Drejtorisë.</p> <p>Me qëllim të ushtrimit të funksioneve të përcaktuara me dispozitat ligjore në fuqi, Drejtoria e Inspektionit, është e organizuar në këta sektorë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1.Spektori i Rendit Komunal; 2.Spektori i Ndërtimit; 3.Spektori i Pylltarisë; <p>Drejtorja e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit</p> <ul style="list-style-type: none"> • Jep pëlqim për shfrytëzimin e hapësirave publike në përputhje me planet dhe rregulloret komunale; • Në bazë të ligjit dhe udhëzimeve administrative, bënë trajtimin e qenve endacakë. • Organizon sigurimin, rregullimin dhe mirëmbajtjen e hapësirave publike përmes inventarizimit; • Në bashkëpunim me banorët, bën rregullimin dhe riparimin e ashensorëve në banesat kolektive; • Bën planifikimin dhe menaxhimin e mirëmbajtjes, rikonstruktimit, zgjerimit dhe modernizimit të rrjetit të ndriçimit publik; • Është përgjegjëse për ndriçimin Publik; • Bën rregullimin dhe mirëmbajtjen e monumenteve, fontanave dhe krojeve publike; • Mbikëqyrë mbledhjen, transportimin deri në deponi të mbeturinave nga amvisëritë, institucionet dhe lokalet afariste, mbeturinave të vëllimshme, mbeturinave ndërtimore, mbeturinave të biodegradueshme dhe kompostimin e tyre, si dhe llojeve tjera të mbeturinave të cilat janë në kompetencë të nivelit lokal; • Organizon dhe mbikëqyrë mirëmbajtjen verore dhe dimërore të shesheve, rrugëve dhe trotuareve në zonën urbane dhe rurale të komunës; • Angazhohet për zvogëlimin gradual të ndotjes, degradimit dhe dëmtit mjedisor, si dhe zvogëlimin ose ndalimin e atyre aspekteve ekonomike dhe të aktiviteteve të tjera që përbëjnë rrezik për shëndetin e njeriut dhe mjedisin; • Angazhohet për zvogëlimin gradual të ndotjes, degradimit dhe dëmtimit të mjedisit përmes eliminimit të deponive ilegale dhe aktiviteteve tjera relevante; • Përcakton lokacionin e kontejnerëve;
--	---

	<ul style="list-style-type: none"> • Informon publikun për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit; • Në përputhje me ligjet dhe aktet komunale, përgatit programin për uljen e nivelit të ndotjes së mjedisit dhe propozon projekte për mbrojtjen e mjedisit, në bashkëpunim me institucione qendrore e lokale dhe donatorë; • Përkujdeset për ruajtjen e ujërave sipërfaqësore dhe atyre nëntokësore nga ndotësit; • Mbikëqyrë administrimin e vlerave natyrore, si: ajri, uji, toka, pyjet, lëndët minerale dhe të mirat natyrore publike; • Vlerëson rrezikshmërinë nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësi të tjera brenda territorit të komunës, si dhe harton planet për mbrojtje; • Kujdeset për funksionimin dhe aktivizimin e Sistemit të Alarmit Publik në rast të rrezikut; • Është përgjegjës për organizimin e qytetarëve në forcat për mbrojtje dhe shpëtim, në rast nevojë si dhe propozimin për themelimin e Komitetit për Mbrojtje dhe Shpëtim; • Në përputhje me ligjet dhe në rast nevojë është përgjegjëse për koordinimin e punëve me institucionet qendrore dhe komunat tjera në fushën e mbrojtjes dhe shpëtimit. • Në rastet e jashtëzakonshme, i propozon Kryetarit të Komunës shpalljen e gjendjes Emergjente, si dhe masave që duhet të ndërmerren për përballimin e situatës; • Kujdeset për mirëmbajtjen dhe funksionalizimin e strehimoreve publike; • Bën pranimin e informatave nga qytetarët, subjektet Komunale dhe i dërgon për personin apo subjektin që i dedikohen (Qendra e thirrjeve); • Në përputhje me ligjet dhe aktet komunale, harton Planin për Mbrojtje nga Zjarri, Planin Operativ Emergjent dhe Planin nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera; • Ndërmerr masa për parandalimin dhe zvogëlimin e pasojave nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera; • Në raste emergjente nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera bën evakuimin dhe strehimin e përkohshëm të qytetarëve; • Bashkëpunon me BPZ-në gjatë intervenimeve emergjente dhe intervenimeve nga zjarri; • Kujdeset për furnizim me ujë të pijshëm me cisterna dhe rezervuarë të veçantë, në rast nevojë; • Ndërmerr masa preventive për parandalimin e vërshimeve përmes pastrimit të Shtratit të lumenjve, kanalizimit atmosferike, pastrimi i përroskave, kanaleve të hapura dhe portave hyrëse; • Bën monitorimin dhe vëzhgimin e kamerave të sigurisë në Qendrën e thirrjeve; • Ndërmerr masa gjatë rasteve emergjente: • Bënë regjistrimin e objekteve të vjetra dhe objekteve tjera me rrezikshmëri të lartë, zonave me rrezikshmëri të lartë nga shembjet e dheut dhe vërshimet; • Koordinon aktivitetin dhe jep pëlqimin për veprimtarinë e transportit publik të udhëtarëve dhe mallrave, me kompanitë publike dhe private; • Cakton linjat dhe rendin e udhëtimit për transportin publik të udhëtarëve, sinjalizimin e vend ndaljeve për autobusë, pritoreve të udhëtarëve; • Cakton lokacionet për parkimin e veturave auto-taksi; • Menaxhon sektorin me “Merimangë”, sipas rregullores, dhe përgatit procedurat për ankand publik për automjetet e konfiskuara, që kalojnë afatin e paraparë me ligj;
--	--

	<ul style="list-style-type: none"> • Bashkëpunon me policinë për rregullimin e komunikacionit dhe ngritjen e sigurisë në komunikacion, në veçanti afër shkollave dhe institucioneve parashkollore; • Kujdeset për sinjalizimin vertikal dhe horizontal të rrugëve ekzistuese dhe rregullon komunikacionin në qytetin e Prishtinës; • Ndërtimi i nyjave të reja të semaforëve në udhëkryqet e qytetit dhe mirëmbajtja e semaforëve ekzistues; • Vendos për mbylljen e përkohshme të rrugëve, për shfrytëzimin e tyre në raste të veçanta (festa shtetërore, punë të veçanta në interes të shtetit dhe komunës dhe punë të ngjashme); • Është kompetente për dhënien e lejeve që i përkasin Komunës, për vendosjen e sinjalizimit; • Mbikëqyrë kushtet e sigurisë së jetës dhe shëndetit të njerëzve në vend ndërtim dhe rreth tij, gjatë zhvillimit të punimeve. <p>Drejtoria e Parqeve ka kompetenca dhe përgjegjësi me si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Krijimi dhe administrimi i parqeve rekreative brenda territorit të komunës së Prishtinës; • Evidentimi i zonave të përshtatshme për krijimin e hapësirave të reja të gjelbra në secilën zonë të kryeqytetit; • Mbrojtja dhe kujdesi ndaj zonave të gjelbra brenda territorit të komunës së Prishtinës; • Administrimi i aseteve rekreative (pajisje, pista e shtigje, ambiente rekreative) që ndodhen në territorin e komunës së Prishtinës; • Krijimi dhe mirëmbajtja e vazhdueshme e këndeve të lojërave për fëmijë; • Nxitja, promovimi, mbështetja dhe organizimi i aktiviteteve rekreative për fuqizimin e jetesës aktive nëpërmjet edukimit e sensibilizimit për një jetesë të shëndetshme, në bashkëpunim me sektorë të tjerë përgjegjës; • Organizimi dhe koordinimi i planeve operacionale të gjelbërimit; • Dhënia e pëlqimit për shfrytëzimin e hapësirave të parqeve për aktivitete kulturore (jo afariste); • Informimi i publikut për çështjet që kanë të bëjnë me ruajtjen dhe mbrojtjen e hapësirave të gjelbra; • Emërtimi hapësirave të gjelbra brenda territorit të komunës së Prishtinës; • Bashkërendimi me dikasterët tjerë të nivelit lokal dhe ministrinë e linjës mbi çështje që lidhen me hapësirat e gjelbra; <p>Drejtoria e planifikimit strategjik dhe zhvillimit të qëndrueshëm Planifikon zhvillimin hapësinor dhe urbanistik, përcjell dhe studion zhvillimin hapësinor brenda territorit të komunës (sipas metodologjisë bashkëkohore); Harton programe, planin zhvillimor të komunës, planin zhvillimor urban dhe planet rregulluese urbane të vendbanimeve dhe tërësive tjera; Ofron sugjerime dhe mendime lidhur me procedurën për miratimin e tyre dhe propozon realizimin e tyre; Mbledh, përpunon dhe plotëson dokumentacionin e zhvillimit hapësinor, në harmoni me Ligjin për planifikimin hapësinor dhe dispozitat tjera të nxjerra në bazë të tij; Bashkëpunon me të gjitha subjektet pjesëmarrëse në planifikimin dhe zhvillimin e qytetit dhe të komunës për hartimin e planeve hapësinore; Merret me planifikimin urban dhe rural të komunës dhe të shfrytëzimit të tokës;</p>
--	--

	<p>Bashkëpunon rreth konceptit të zgjidhjeve dhe përmbajtjeve të planeve rregulluese urbane;</p> <p>Harton programe, detyra projektuese, me ndihmën e ekspertëve të përzgjedhur për organizimin e konkurseve urbanistko – arkitektonike në nivel vendor dhe ndërkombëtar;</p> <p>Koordinon dhe menaxhon mbledhjen e informatave për GIS nga organizatat dhe drejtoritë tjera të Komunës.</p> <p><u>Sektori i Planifikimit strategjik</u> është pjesë e Drejtorisë së Planifikimit strategjik dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Sektori është përgjegjës për analizat, propozimin dhe hartimin e planeve urbane dhe planeve të hollësishme urbane si dhe në mungesë të stafit në mbikëqyrjen e hartimit të planeve nga kompani private. Sektori merret me lëshimin e informimeve nga planet për Komunën e Prishtinës, në përputhje me dokumente të vlefshme të Planifikimit Strategjik.</p> <p>Aktet që lëshohen nga ky sektor:</p> <p>Informatat nga plani</p> <p>Pëlqimet për parcelim</p> <p>Pëlqimet për bashkim parcelash</p> <ul style="list-style-type: none"> • Punë të tjera në kuadër të fushë-veprimtarisë së Drejtorisë, në përputhje me ligjet në fuqi. <p>Komuna e Prishtinës ka të hartuar një dyzinë planesh zhvillimore dhe plane rregulative:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Plani Zhvillimor Komunal i Prishtinës 2012-2022 • Plani Zhvillimor Urban - Prishtina 2012-2022 • Plani Rregullues Urban - Prishtina e re - Zona Lindje • Plani Rregullues Urban - Prishtina e re - Zona Perëndim • Plani Rregullues i Hollësishëm - Kodra e Trimave 1 2017-2025 • Ndryshimi dhe Plotësimi i Planit Rregullues Urban - ARBËRIA 3 • Plani Rregullues Urban - Dardania • Plani Rregullues Urban - Dodona • Plani Rregullues Urban - Kalabria • Plani Rregullues Urban - Lakërishtë • Plani Rregullues Urban - Mati 1 • Plani Rregullues Urban - Mati 3 • Plani Rregullues Urban - Medrese-Çamëri • Plani Rregullues Urban - Muhaxhirët • Plani Rregullues Urban - Pejton • Plani Rregullues Urban- Prishtina e re - Zona Qendër • Plani Rregullues Urban - Qendra 1 • Plani Rregullues Urban - Qendra 2 • Plani Rregullues i Hollësishëm - Sofalia 2016-2024 • Plani Rregullues Urban - Tophane • Zona Urban - Qendra Ulpiana • Plani Rregullues Urban - Zona Ekonomike • Plani Rregullues i Hollësishëm për tërësinë urbane "B" të lagjes Prishtina e Re – Zona Lindje në Prishtinë 2017-2025 • Plani rregullues i hollësishëm për zonën "Mati 1", vazhdimi i rrugës "B" (Bahri Fazliu), pjesa jugore • Plani Rregullues i Hollësishëm për Blloqet "B 17", "B 18", "B 19" dhe "B 20" të lagjes Mati 1 në Prishtinë 2017-2025
--	---

	<ul style="list-style-type: none"> • Plani Rregullues i Hollësishëm për tërësinë urbane “B” të lagjes Prishtina e Re – Zona Lindje në Prishtinë 2017-2025 • Revidimi i Planit Rregullues të Hollësishëm për tërësinë urbane “B” të lagjes “Prishtina e re – Zona Lindje” <p>Po ashtu, Komuna e Prishtinës ka hartuar Planin e Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban për të kuptuar plotësisht problemet aktuale të rrjetit të transportit dhe për të identifikuar zgjidhjet e mundshme. Qëllimi është që qyteti të lëvizë drejt praktikave më të qëndrueshme të transportit, që do të ndihmojnë në arritjen e objektivave të transportit të qëndrueshëm dhe të cilësisë së ajrit. Plani bazohet në zhvillimin e një modeli të ri të transportit dhe në vlerësimin e opsioneve të ndryshme për përmirësimin e gjendjes aktuale të komunikacionit, transportit dhe parkimit, me qëllim nxitjen e ndryshimit të sjelljes dhe nxitjen e një ndryshimi në transportin modal drejt alternativave më të qëndrueshme.</p>
1.4 Gjendja aktuale në sektorin përkatës	<p>Përshkrimi i situatës aktuale</p> <p>Gjendja e tanishme në kryeqytet, ku ka elemente të trashëguara të planifikimit të cilat janë në zbatim e sipër, një pjesë e tyre vetëm në fazën e planifikimit, komunikacioni i stërngarkuar, objekte të shumta të ndërtuara pa zbatim të plotë të rregullatës përkatëse, shumë të tilla me tejkalime si në sipërfaqe, po ashtu edhe në etazhitet, tejkalime në vijat rregulluese dhe ndërtimore, dhe mangësi në trajtimin adekuat në aspektin e mbrojtjes dhe sigurisë së jetës dhe shëndetit. Janë të evidentuara por jo edhe të sistemuara shkeljet në ndërtim dhe tejkalimet në shumë raste, por të njëjtat nuk janë të sistemuara dhe nuk ka regjistra unik dhe nuk ka prezantime përkatëse dixhitale apo analoge. Kjo vështirëson monitorimin e gjendjes, planifikimin dhe zbatimin e strategjisë së re zhvillimore interaktive të Kryeqytetit.</p> <p>Siguria e këmbësorëve, është problematike për shkak të planifikimit të gabuar apo mos planifikimit të zonave të sigurta, sinjalizimit të dobët nëpër rrugët e Kryeqytetit, dhe moszbatimit të plotë të planifikimit ekzistues.</p> <p>Planet rregulluese janë të gjitha të prezantuara me standarde të ndryshme, dhe të njëjta nuk janë të paraqitura së bashku, kështu që planifikimi është kryer parcialisht, me pak përshtatje në zonat përreth</p> <p>Shërbimi për qytetarin, posaçërisht në lëmin e zbatimit të Planeve rregulluese, nëpërmjet portalit online nuk është mjaftueshëm i promovuar, dhe i mungon ndërlidhja mes drejtorive përkatëse (Urbanizëm, Kadastër, Inspektion, Planifikim strategjik...) dhe shërbimeve përkatëse komunale dhe Shërbimeve. Portali qëndron ende në versionin provues “Beta”.</p> <p>Edhe shërbimet aktuale të portalit kërkojnë një rifreskim dhe një ripërtëritje, përshtatje me trendet aktuale, dhe me sasinë gjithnjë e më të madhe të shënimeve të përfshira dhe atyre që do të përfshihen.</p> <p>Drejtoritë përkatëse, me shërbimet e tyre, me personelin dhe me teknikën që posedojnë, në pyetësorët e fundit të dërguar, kanë marrë përsipër kryerjen e vetëm një pjesë të detyrave të reja të identifikuar, dhe në pamundësi të kryerjes të gjitha detyrave përbrenda shërbimeve dhe drejtorive të Komunës, një pjesë e tyre imponohet të procesohet në kryerje me ndihmën e konsulencës së kontraktuar.</p>

1.5 Programet e ngjashme dhe veprimtari të tjera të donatorëve:	Identifikimi dhe përshkrimi i lidhjes: Plani i mobilitetit; Studimet zhvillimore; Planet ekzistuese urbane; Pako programe ne zhvillim për eLeje
2. OBJEKTIVI, QELIMI & REZULTATET E PRITURA	
2.1 Qëllimi i përgjithshëm	Formimi i shërbimit të Arkitektit të Kryeqytetit Krijimi i Hartës unike të planifikimit të Kryeqytetit Krijimi i Bazave të shënimeve Krijimi i Bazës së Sistemit Gjeografik të Informacionit Krijimi i rregulloreve dhe manualeve të nevojshme për funksionimin e pakove programore për përcjelljen e lejeve, ndërtimeve, mirëmbajtjeve, tatimit dhe shërbimeve komunale. Krijimi i sistemit interaktiv online të komunikimit me qytetarët
2.2 Qëllimi	Qëllimi i këtij projekti është si më poshtë: Zbatimi i synimeve të Autoritetit Kontraktues për themelimin e shërbimit të Arkitektit të Kryeqytetit. Përcjellja e procedurave në ndërtim, mirëmbajtje, ndërtim, meremetim, rekonstruktim, kontrolle të kualitetit, zbatim të rregulloreve të veçanta të Kryeqytetit Krijimi i veglave programore për platformat kompjuterike për komunikim të shërbimeve të komunës me qytetarët Krijimi i databazave interaktive të shënimeve të nevojshme për planifikim, identifikim dhe shënim të objekteve, pronave, hapësirave; gjendja e tyre aktuale dhe e planifikuar; incizimet e pronave komunale dhe hartimi i planeve të mirëmbajtjes së rregullt dhe periodike; Planifikimet ad-hok sipas nevojave emergjente; rregullimi i komunikacionit motorik dhe të këmbësorëve dhe përshtatja me strategjitë zhvillimore dhe ato në zbatim. Përcjellja e informatave dhe transferi i metodologjisë së krijuar për shërbimin të shërbimi i ardhshëm i Arkitektit të Kryeqytetit
2.3 Rezultatet që duhet arrihen nga Konsulenti	PRITSHMËRITË NË PERFUNDIM TË KONSULENCËS <ul style="list-style-type: none"> • Arritja e objektivit të parashtruar të funksionalizimit të përcjelljes së të gjitha ndërtimeve online, deri te certifikimi final i tyre. Mundësia e përcjelljes së afateve të Shërbimit, mirëmbajtjes dhe sigurisë së pajimeve relevante të objekteve komunale. • Trajnimi i personelit për shfrytëzimin të veglave programore bashkëkohore, përfshi edhe menaxhimin e informatave të ndërtimit [BIM - Building Information Management] • Përpilimi i Manualeve të përgatitjes së dokumentacionit për lejet e ndërtimit • Formimi dhe menaxhimi i bazës unike të shënimeve lidhur me ndërtimet, relacionet pronësore, infrastrukturës dhe në veçanti objekteve nën menaxhim direkt, me theks në menaxhimin e mirëmbajtjes së objekteve të Komunës: shkollave, ambulancave etj. në kohë reale. • Formimi i bazës së shënimeve të kostove mesatare të ndërtimit, meremetimit, mirëmbajtjes, rindërtimit të nevojshëm për vlerësime, për nevoja të prokurimit dhe për planet strategjike të Kryeqytetit • Formimi i Hartës Unike të Kryeqytetit, shumë shtresore, për nevoja të planifikimit, zhvillimit dhe strategjisë së Kryeqytetit, për veprim të shërbimeve të mbrojtjes dhe sigurisë, shpëtim; për shërbimet komunale, shërbimet e furnizimit dhe të ngjashme; për

Raporti i Ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën numër PSH. Nr. 44/23, të "Alb -Architect " SH.P.K, Prishtinë, pjesëmarrës në ftesën për ofertë lidhur me aktivitetin e prokurimit "Konsulencë për themelimin e Shërbimit të Arkitektit të Kryeqytetit për nevojat e Komunës së Prishtinës " me numër të prokurimit: 616-22-7431-3-1-2 iniciuar nga AK/ – KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS,,

	<p>mirëmbajtje të rregullt dhe për riparime të infrastrukturës tokësore, nëntokësore dhe ajrore.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Formimi i bazës së rregullave dhe rregulloreve specifike në relacion me Kryeqytetin, të vendimeve të veçanta, në lëminë e planifikimit hapësinor, projektimit të godinave dhe shesheve, kriteret për vendosjen e objekteve të përkohshme, ndaj ndërtimeve, pajisjeve dhe elementeve mikro – urbane në territorin e qytetit dhe të komunës • Formimi i bazës së shënimeve të sublimuara të objekteve sipas kategorive, statusit dhe gjendjes, me pasqyrim grafik dhe në prezantim përkatës tredimensional, volumetrik – hapësinor, përfshi të gjitha shënimet relevante të informacionit, të lidhura me vëdi. • Formimi i ekipeve profesionale, të rekrutuara nga stafi i komunës, dhe të trajnuara për vazhdimin e dhënies së konsulencës teknike dhe profesionale, për të siguruar vazhdimësinë e procesit të konsulencës me kryerësit e punësuar në Komunë. • Themelimi dhe organizimi i shërbimit të Arkitektit të Kryeqytetit dhe degëve të tij, në fund të procesit të tranzicionit të shërbimit të konsulencës.
3. SUPOZIMET & RREZIQET	
3.1 Supozimet që ndërlidhen me projektin	<p>3.1.1. Në përfundim të projektit do të realizohen të gjitha detyrat e këtij projekti</p> <p>3.1.2. Në periudhën përcjellëse të projektit do të transferohet metodologjia dhe shënimet të shërbimit të themeluar i Arkitektit të Kryeqytetit</p>
3.2 Rreziqet	<p>3.2.1 Ndërhyrjet të paplanifikuara në rregulativen ekzistuese gjatë fazës së zhvillimit të projektit</p> <p>3.2.2 Mosrespektimi i kontratës nga operatori ekonomik;</p> <p>3.2.3 Ndryshimi i planeve komunale që ndikojnë në fushat që përfshin ky projekt.</p>
4. FUSHEVEPRIMI	
4.1 Gjenerale	<p>Përshkrimi i projektit –</p> <p>Përmes këtij projekti synohet të analizohen çështje të rëndësishme të cilat ndikojnë në ngritjen e nivelit të shërbimit dhe sigurisë në rrugët dhe hapësirat publike brenda komunës së Prishtinës. Gjithashtu synohet të bëhet analiza e gjendjes aktuale, të arrihet qëllimi i planifikimit strategjik afatgjatë përmes platformës së dixhitalizimit, dhe paraqitja e tyre përmes software-it adekuat.</p> <p>Grupet e synuara</p> <p>Qytetarët, kontraktorët, ndërtuesit, inxhinierët dhe arkitektët pjesëmarrës në proceset investive, planerët, personat me nevojë dhe personat me aftësi të veçanta, pjesëmarrësit në trafik, transporti publik urban, shërbimet e taksive dhe transportit të mallrave dhe materialeve, Ndërmarrjet publike, Zjarrfikësit, Emergjencja, Policia e Kosovës, institucionet e shëndetit publik, institucionet parashkollore dhe shkollore, shoqatat relevante, bizneset lokale, administrata komunale.</p>
4.2 Aktivitetet specifike	<p>Kërkesat e specifikuar:</p> <p>1. PUNIMI I PAKOVE PROGRAMORE SOFTVERIKE, zhvillimi i programeve për platformat Windows, IOS dhe Android, analiza e kërkesave, nevojave dhe pritshmerive për periudhën 2023-2025. Pakot programore i dorëzohen AK pas periudhës tranzitore të paraparë, bashkë me kodin burimor (“source code”) për nevojat të përkrahjes dhe mirëmbajtjes së pakove programore.</p> <p>1.1. Programimi dhe dizajnimi i faqes kryesore të portalit të shërbimit interaktiv për qytetarin të quajtur “Infofaqja” me ndërfaqen për shërbimet përkatëse,</p>

	<p>ekzistuese dhe te reja të parapare sipas kërkesës së AK për konsulentin, vegëz-lidhjet me faqet aktuale të portalit të komunës, dhe mundësinë interaksionit mëto [Kadastrri, Inspekcioni, etj]. Ndërfaqja për prezantimin e ekspozitave me projekt propozimet konkurruese në konkurset për projektet e arkitekturës dhe të ngjashme, me modulën e veçantë të votimit të qytetarit, të lidhur me çelësin e identifikimit, sipas numrit identifikues të qytetarit, nga portalet shërbyese publike të Republikës së Kosovës.</p> <p><i>Modul softuerik, çmimi ipet per 1 cope</i></p> <p>1.2. Redizajnimi, reprogramimi dhe funksionalizimi i modulit programor, “eLeja”, sipas kërkesave të komunikimit interaktiv me qytetarin, online, me mundësinë e ngarkimit të dokumenteve të nevojshme për procedurën e Lejes ndërtimore. Mirëmbajtja e platformës dixhitale, për shërbimet e aplikanteve të lejeve të ndërtimit online për territorin e Kryeqytetit, me të gjitha shënimet e nevojshme duke përfshirë edhe shënimet dixhitale e ato të skanuara.</p> <p><i>Modul softuerik, çmimi për 1 cope</i></p> <p>1.3. Programimi, dizajnimi formimi i pakos programore softverike për dixhitalizimin dhe organizimin, përgatitjen dhe formësimin e ndërfaqes së shfrytëzuesve të “Sistemit të përcjelljes së procesit për lëshimin e lejes së ndërtimit” (me min. 3 nivele te autorizimit te qasjes); ndërlidhja me “Portalin e qytetarëve dhe “Infofaqen” Pranimi i kërkesave të reja për leje ndërtimore, pas aprovimeve paraprake apo edhe pa to, dixhitalizimi i materialit dhe/apo përshtatja me standardin e kërkuar, përcjellja ne portalin e Drejtorisë se Urbanizmit, te Drejtorisë se Inspekcionit, te Kadastrit, për procedim; mirëmbajtja dhe përditësimi i “sistemit te përcjelljes...” ne kohe reale sipas shënimeve te pranuar nga Drejtoria përkatëse, organizimi i bazave te shënimeve dhe prezantimi i tyre statistikor, ne forme numerike dhe grafike. Adaptimi dhe përshtatja me Ligjet ne fuqi, udhëzimet administrative dhe rregulloret e ardhshme të Kryeqytetit.</p> <p><i>Modul softuerik, çmimi për 1 cope</i></p> <p>1.4. Programimi, dizajnimi formimi i pakos programore softverike me dizajnimin e ndërfaqeve për komunikim të lehtësuar; për të mundësuar dixhitalizimin dhe paraqitjen e hartave ekzistuese PRRU dhe PZHU dhe adaptimi i tyre për prezantim online; i quajtur “eHarta”, përgatitja për përfshirjen e Hartave të ardhshme zonale; për vendosjen e gabariteve të objekteve të ardhshme sipas lejeve të lëshuara, atyre në pritje për leje dhe objekteve të ndërtuara, sipas kategorizimit: të rregullta dhe të tejkaluara. Platforma për formimin e hartës së urbanizmit hapësinor për paraqitjen volumetrike të objekteve publike dhe shumë banesorë të ndërtuara me identifikimet dhe kategorizimet e tyre, për nevoja të planifikimit strategjik dhe mirëmbajtjen e rregullt të infrastrukturës dhe godinave; ndërlidhja me bazën e shënimeve për projektet e objekteve të trajtuara në BIM. Baza e te dhënave nga platformat “open source” dhe përfshirja e shënimeve me metodën e Web Scraping. Shënimet specifike dhe</p>
--	--

	<p>të veçanta përfshihen nga platformat suportuese me ndërfaqjen e lehtë për punë jo ma shume se 3 hapa [komanda] deri te rezultati i kërkuar specifik.</p> <p><i>Modul softuerik, i punuar ne ndonjë nga GIS OS, çmimi për 1 cope</i></p> <p>1.5. Programimi, dizajnimi formimi i pakos programore softverike për komunikim interaktiv “Portali i qytetarëve”, rrjeti unik social i qytetarëve të Prishtinës, për propozime, dhënie idesh, vërejtje dhe sugjerime, kërkesa të ndryshme, me ndërfaqosje me mundësi të qasjes sipas identitetit të vërtetuar, me mundësi të shkëmbimit të teksteve, fotografive dhe video porosive të shkurta, organizimit të grupeve të lajmërimit, publikimit të shpalljeve dhe vendimeve të administratës komunale, Këshillave të Lagjes dhe atyre të ndërtesave, me modulën e veçantë të lajmërimit, të quajtur “Kumtari dixhital nëpërmjet të cilit edhe në mënyrë inkognito, pa zbulimin e identitetit mund të kryhet lajmërimi për problemet e veçanta, parregullsitë apo të ngjashme, në territorin e komunës, e gjitha me mundësi të redaktimit në disa nivele [min. 3 nivele] në lëmin e infrastrukturës dhe ndërtimit.</p> <p><i>Modul softuerik, çmimi për 1 cope</i></p> <p>1.6. Programimi, dizajnimi, funksionalizimi dhe mirëmbajtja e platformës softverike, të ofrimit të shërbimeve të besuara, konform DISPOZITABVE Të Ligjit Nr.08/L-022 për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara nëtransaksionet elektronike, për deponimin e nënshkrimit elektronik të kualifikuar, dhe vulës elektronike, i quajtur “e Nënshkrimi”, përmes furnizimit me Çelësin elektronik vërtetues dy-faktorës (SecurID Authenticator) – Token, dhe qasjen për azhurnimet ditore të shfrytëzuesëve, sipas niveleve të sigurisë gjegjësisht administrimit. Shërbimi, në këtë fazë do të kryhet vetëm për pjesëmarrësit e proceseve investive në lëminë e ndërtimit dhe infrastrukturës, me mundësi të zgjerimit sipas nevojës. Identifikimi i përdoruesve duhet të verifikohet përmes platformës së gjendjes civile dhe po ashtu duhet të verifikohet edhe numri i telefonit dhe e-mail gjatë hapjes së llogarisë.</p> <p><i>Modul softuerik, çmimi për 1 cope</i></p> <p>1.7. Programimi, dizajnimi formimi i pakos programore softverike për komunikim interaktiv të shërbimeve të drejtorive komunale, “ePërcjellja”, për shërbimet të inspektionit, kadastrit dhe urbanizmit, për kontrollin e ndërtimeve nga faza e aplikimit deri te faza e kolaudimit të objekteve dhe të ndërtimeve, e gjitha e lidhur me portalin e Arkitektit të Kryeqytetit, “eArkitekti”.</p> <p><i>Modul softuerik, çmimi për 1 cope</i></p> <p>1.8. Formimi i portalit “Prishtina ne shuplake dore” si udhërrëfyes turistik dhe kulturor i Kryeqytetit për vendosjen e objekteve të skanuara dhe modeluara në teknikën 3D, për prezantimi virtual te vendtakimeve, objekteve të posaçme, atyre historike, të trashëgimisë kulturore, të museumeve të Kryeqytetit, stacionet e autobusëve dhe taksive, linjat e komunikacionit publik, oraret, dhe ngjarjet sezonale, objektet me rëndësi, kafenet dhe</p>
--	--

	<p>restorantet, hotelet dhe bujtinat, dhe të gjitha shënimet tjera të vlefshme për prezantimin bashkëkohor të Kryeqytetit.</p> <p><i>Modul softuerik, çmimi për 1 cope</i></p>
	<p>2. PËRFSHIRJA E SHËNIMEVE NË PLATFORMAT SOFTVERIKE DHE NË BAZAT E SHËNIMEVE, azhurnimi i shënimeve të vjetra, formimi i bazave të shënimeve dhe përfshirja e shënimeve të reja</p> <p>2.1. Dixhitalizimi i lejeve ekzistuese të lëshuara në vitin 2022 [ose më herët] dhe përfshirja e shënimeve në bazat përkatëse të shënimeve; unifikimi dhe standardizimi i dokumenteve të deritashëm, të skanuara apo analoge, të gjitha në një format dhe madhësi unike sipas standardit të dokumenteve, arhivimi dhe riskanimi aty ku do të paraqitet nevoja, apo në rastet kur mungon një i tillë..</p> <p><i>Përfshirje shënimesh me trajtim dixhital, çmimi për 1 cope</i></p> <p>2.2. Dixhitalizimi i kërkesave që do të arrijnë dhe pëlqimeve për leje të reja ndërtimore në baza ditore, sipas pranimit, dhe përfshirja e shënimeve në bazat përkatëse të shënimeve; pozicionimi i gabariteve volumetrike sipas Planeve hapësinore, në sistemin informativ gjeografik, gjegjësisht në hartat përkatëse dixhitale</p> <p><i>Përfshirje shënimesh me trajtim dixhital, çmimi për 1 cope</i></p> <p>2.3. Dixhitalizimi i objekteve ekzistuese, të ndërtuara apo në ndërtim para aplikimit të softverit për përcjellje dixhitale, dhe përfshirja e shënimeve të tyre, në bazat përkatëse të shënimeve; pozicionimi i gabariteve volumetrike në sistemin informativ gjeografik, në hartat përkatëse dixhitale</p> <p><i>Përfshirje shënimesh me trajtim dixhital, çmimi për 1 cope</i></p> <p>2.4. Dixhitalizimi i shënimeve të lejeve të reja të lëshuara, nga Drejtoria Urbanizmit, bashkë me shtesat/aneksat e tyre, në bazën e formuar dixhitale të shënimeve dhe ndërlidhja me portalin kryesor dhe sistemin e përcjelljes. Dixhitalizimi i situacioneve përkatëse; azhurnimi në hartat digjitale dhe ndërlidhja e shënimeve të projekteve dhe shënimeve të digjitalizuara me sistemin e lajmërimit në Drejtorinë e Inspektionit dhe Drejtoritë tjera të interesuara.</p> <p><i>Përfshirje shënimesh, çmimi për 1 njësi të shënuar</i></p> <p>2.5. Specifikimi dhe azhurnimi i njësive banesore, komerciale dhe të tjera, identifikimi i njehsorëve të ujit, të elektrikes dhe eventualisht të gasit, kalorimetrave, formimi i regjistrave të njësive banesore dhe komerciale, me karakteristikat fizike dhe gjeografike, për nevojat e kadastrit etazhor, të sektorit të pronave dhe të shërbimeve komunale, për objektet e trajtuara.</p> <p><i>Përfshirje shënimesh, çmimi për 1 njësi të shënuar</i></p> <p>2.6. Përfshirja dhe vendosja e shënimeve në bazat përkatëse softverike, dhe numerike, përfshirja e teksteve përcjellëse dhe formimi i Hartës unike të planifikimit me përfshirjen e të gjitha shënimeve të disponueshme, përditësimi i saj në baza javore, dhe mirëmbajtja e rregullt.</p>

	<p>2.6.1. <i>Përfshirja e informatave dixhitale nga bazat ekzistuese të shënimeve në posedim të AK ose etniteteve të tjera të disponueshme ekzistuese të autoritetit kontraktues (të ujit, të kanalizimeve, të shpërndarjes së ngrohjes, të elektrikes, internetit dhe telefonisë) dhe transmetimi i tyre në GIS</i></p> <p>2.6.2. <i>Përfshirja e informatave analoge nga projektet ekzistuese, të autoritetit kontraktues (të ujit, të kanalizimeve, të shpërndarjes së ngrohjes, të elektrikes, internetit dhe telefonisë) dhe transmetimi i tyre në GIS</i></p> <p><i>Përfshirje shënimesh, çmimi për 1 javë mirëmbajtje</i></p> <p>2.7. Udhëheqja dhe mbajtja e regjistrit të nënshkrimeve të deponuara dixhitale, për pjesëmarrësit e procesit investiv bashkë me furnizimin e pjesëmarrësve me Çelësin dixhital të autentifikimit</p> <p><i>Përfshirje shënimesh, çmimi për 1 njësi të shënuar</i></p> <p>3. SHËRBIMET PËR QYTETARË</p> <p>3.1. Pranimi dhe trajtimi i kërkesave për kushte për leje ndërtimore, nëpërmjet platformës online të eLejes apo nga shërbimi përkatës komunal, dixhitalizimi i të njëjtave, azhurnimi dhe përfshirja e shënimeve në bazat përkatëse të shënimeve, mirëmbajtja e “Sistemit të përcjelljes së procesit për lëshimin e lejes së ndërtimit”, ekspertiza për vlerësimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve të parapërcaktuara [Ligjore, të planeve respektive, konformiteti me rregulloret e veçanta, etj.] përcjellja për verifikim final në Drejtorinë përkatëse dhe kthimi dhe përgjigja online;</p> <p>3.1.1. <i>Për sipërfaqe të trajtuar, çmimi për 1 m²</i></p> <p>3.2. Shërbimi “one-stop-shop” për furnizimin e aplikuesëve për leje të ndërtimit me pëlqimet për kycjet në infrastrukture [KEDS, KUR Prishtina, Termokos, PTK, K. Prishtine], dhe përfshirjen në trajtim të mbeturinave urbane, pastrim të rrugëve të qasjes gjatë ndërtimit dhe shërbimet tjera komunale; ndërlidhja (përfshirja e shënimeve) në sistemin intern të përcjelljes të Drejtorive përkatëse, lajmërimi i kompletimit të kërkesave në portal.</p> <p><i>Çmimi për 1 shërbim</i></p> <p>4. SHËRBIMET E DIZAJNIT GRAFIK, VIDEO DHE POST PRODUKSIONIT</p> <p>4.1. Dizajnimi dhe publikimi i teksteve të shkurta, njëfaqëshe, të posterëve, për shumëzim apo emitim, të ikonografikave informuese, edukuese dhe vetedijesuese për kampanjat përkatëse promovuese të Kryeqytetit</p> <p><i>Dizajn grafik, çmimi për 1 njësi në përbërje: poster/pllakat, fletëpalosje, slajde për emitim apo publikim në portal, TV ose programe multimediale</i></p> <p>4.2. Dizajnimi dhe publikimi i teksteve të përgatitura [rregulloret, vendimet, lajmërimet e Kuvendit/Kryetarit/Drejtorive] jovoluminoze deri 24 faqe, me</p>
--	---

	<p>kopertinë të dizajnuar veçmas për botim, me përfshirjen e ilustrimeve të gatshme dhe/apo të punuara enkas për nevoja të informimit, vetëdijesimit dhe propagimit. Botimet të përshtatshme për shtyp dhe për publikim në portalin kryesor <i>Dizajn grafik, çmimi për 1 njësi</i></p> <p>4.3. Incizimi, dizajnimi dhe/apo produksioni i programeve të shkurta informuese lidhur me aksionet dhe/ose vendimet e komunës në lëmin e planifikimit, ndërtimit dhe infrastrukturës, me incizimet eventuale apo shfrytëzimin e incizimeve ekzistuese, punimin e animacioneve, regjia dhe skenari i përgatitur paraprakisht për aprovim nga AK, montazha dhe prodhimi final në formatet përkatëse për emitim HD TV dhe për publikim në portal, të madhësisë 1 deri 5 minuta. <i>Audio-video produksion, çmimi për 1 minutë</i></p> <p>5. SHËRBIME TË KONSULENCËS TEKNIKE, HULUMTUESE DHE SHKENCORE</p> <p>5.1. Përgatitja për standardizimin e prezantimit të projekteve të ndërtimit; Dizajnimi dhe formësimi i shablloneve për unifikimin e prezantimit të projekteve në sistemin BIM, sipas kategorive të ndërtimit. Përpilimi dhe përditësimi i Manualeve të përdorimit <i>Shabllon për Revit, për Archicad, çmimi për 1 cope</i></p> <p>5.2. Përgatitja për standardizimin e prezentimit të projekteve dhe të planeve urbanistike, hartave zonale dhe dokumenteve të planifikimit hapësinor; shabllonet e paraqitjes grafike dhe unifikimi i dokumentacionit për nevoja të publikimit online. <i>Pune inxhinierike, çmimi i përcaktuar për 1 cope</i></p> <p>5.3. Përgatitja e rregulloreve unike të Kryeqytetit për aplikimin e standardeve dhe normave të projektimit dhe ndërtimit bashkë me manualët përkatës sipas kërkesave dhe strategjive planifikuese dhe zhvillimore, të Kryetarit dhe/ose shërbimeve të tij apo Drejtorive të Komunës; angazhimi i eksperteve të listuar, për konsultime, sugjerime, përfshi akordimin me Ligjet dhe Udhëzimet administrative në fuqi, përgatitja paraprake e draft dokumenteve për aprovim, të prodhuara, si dokumentacion për nevoja të vendimmarrjes, aprovimit dhe shpërndarjes, si dhe publikimit online.</p> <p>5.3.1. Përmbledhja e standardeve dhe normave në fuqi, redaktimi dhe përgatitja, për hartimin e rregulloreve unike të Kryeqytetit, për projektim dhe ndërtim <i>Çmimi për një paragraf, figurë dhe/apo tabele të emëruar të dokumentit</i></p> <p>5.3.2. Grumbullimi i normave dhe standardeve të huaja, të regjionit dhe të vendit, përkthim, redaktimi dhe adaptimi për hartim të rregulloreve unike të Kryeqytetit, për projektim dhe ndërtim <i>Çmimi për një paragraf, figurë dhe/apo tabele të emëruar të dokumentit</i></p>
--	--

	<p>6. KONSULENCË DHE VLERËSIME PËR NEVOJA TË DREJTORIVE KOMUNALE</p> <p>6.1. Shërbime të konsulencës dhe projektimit të arkitekturës, për nevoja emergjente të Kryeqytetit, bashkë me hartimin dhe llogaritjen e të gjitha fazave të procesit investiv, sipas kategorive:</p> <p>6.1.1. projektim për kategorinë I</p> <p>6.1.2. projektim parcial për kategorinë I</p> <p>6.1.3. projektim për kategorinë II</p> <p>6.1.4. projektim parcial për kategorinë II</p> <p>6.1.5. projektim rekonstruimi për kategorinë I</p> <p>6.1.6. projektim parcial rekonstruimi për kategorinë I</p> <p>6.1.7. projektim rekonstruimi për kategorinë II</p> <p>6.1.8. projektim parcial rekonstruimi për kategorinë II</p> <p>Çmimi të ipet sipas udhëzimeve në tabelat "Kuotimi i çmimeve"</p> <p>6.2. Shërbimet e konsulences dhe projektimit të urbanistikës, për nevoja emergjente të Kryeqytetit sipas pozicioneve:</p> <p>6.2.1. <i>Intervenimet në përshtatjen e devijimeve të pariparueshme në kuader të PRrU dhe PZhU, në realizim e sipër, kur shfaqet nevoja për zgjidhje të shpejta, me procedura të kontraktimit kornizë, për të realizuar: analiza të gjendjes, propozim të zgjidhjes me arsyetim dhe prezentim tekstual, numerik dhe grafik të varianteve me të përshtatshme të aplikueshme; me studime të shpejta, të gjendjes dhe ofrim të zgjidhjeve adekuate.</i></p> <p>Çmimi të ipet sipas udhëzimeve në tabelat "Kuotimi i çmimeve"</p> <p>6.2.2. <i>Studimet lokale të lokacionit, në pjesët e identifikuar që janë pa mbulesë me dokumentacion të planifikimit hapësinor, ose të mbuluara me dokumentacion të mangët, të pasaktë, apo në rastet kur dokumentacioni nuk mund të aplikohet nga shkaku i gjendjes së ndryshuar apo të gjendjes së ndryshuar në teren, me qëllim që të realizohet: studimi i lokacionit, me analizën e gjendjes, propozim të zgjidhjes me arsyetim dhe prezantim tekstual, numerik dhe grafik të varianteve me të përshtatshme të aplikueshme. Intervenimet e vogla deri të mesme në përshtatjen e gjendjes me planet e vlefshme urbanistike, që nuk i nënshtrohen ndryshimit të parametrave të planeve që trajtohen.</i></p> <p>Çmimi të ipet sipas udhëzimeve në tabelat "Kuotimi i çmimeve"</p> <p>6.2.3. <i>Intervenimet në projektim të pejsazhit urban</i></p> <p><i>Studimet, analizat dhe propozimet e përshtatjes së pamjeve, dukjeve, profileve, elementeve urbane dhe atyre ndërtimore për arritjen e unifikimit apo përshtatjes së objekteve dhe tërësisë së planifikuar sipas rajoneve, lagjeve ose rrugëve të caktuara, përfshirë, planifikimet dhe zgjidhjet peizazhore urbane, të objekteve</i></p>
--	---

	<p><i>të trajtuara në fazën e legalizimit, si dhe ndërhyrjet eventuale në objektet ekzistuese</i></p> <p><i>Çmimi të ipet sipas udhëzimeve në tabelat "Kuotimi i çmimeve"</i></p> <p>6.2.4. Hartimi i urbanizmit të përkohshëm, përpilimi i kriterëve për vendosjen e objekteve mobile: për ngjarjet periodike dhe festimet, vendosja e objekteve sezonale të përkohshme, i instalimeve dhe instalacioneve, dispozitat për shfrytëzimin e hapësirës publike, specifikimi i kriterëve për lejimin e objekteve të përkohshëm sipas kriterëve të veçanta të Kryeqytetit, zgjidhjet urbanistike të platove, të organizimit të terracave të objekteve hoteliere dhe të ngjashme, në hapësirat private dhe publike, për vendosje të çadrave dhe tendave sezonale për mbrojtje nga djellëzimi, përpilimi i kriterëve për shfrytëzimin ambulator të hapësirave publike dhe të ngjashme. Çmimi të ipet sipas udhëzimeve në tabelat "Kuotimi i çmimeve"</p> <p>6.2.5. Shërbim konsulence dhe projektimi për shtesat e objekteve, anekset, terracat, platotë dhe objektet tjera që i nënshtrohen trajtimit të shfrytëzimit të sipërfaqeve publike, përshtatja me normat dhe rregulloret e veçanta, definimi i shfrytëzimit të sipërfaqes, Çmimi të ipet sipas udhëzimeve në tabelat "Kuotimi i çmimeve"</p> <p>6.3. Dizajnimi ad-hok hapësirës së së pjesshme të shesheve, oborreve, hapësirave të përbashkëta të jashtme, dhe mobiluarit urban për vendosja e tij në hapësirë, instalacionet dhe veglat për loje të fëmijëve, punimi i dokumentacionit për prodhimin e tyre. Çmimi të ipet sipas udhëzimeve në tabelat "Kuotimi i çmimeve"</p> <p>6.4. Hulumtim dhe/ apo identifikimi i sipërfaqeve të gjelbëruara, dhe/ose sipërfaqeve që do të mund të gjelbërohen, në kuadër të Planeve urbanistike dhe udhëzimeve të Kryetarit/Shërbimit përkatës, propozimi i parqeve dhe mini parqeve në zonat urbane, vlerësimi i gjendjes, propozimi i trajtimit, projekti i zgjidhjes dhe i peizazhit me specifikimet e detajizuara për kryerësit e punëve. Çmimi të ipet sipas udhëzimeve në tabelat "Kuotimi i çmimeve"</p> <p>7. ORGANIZIMI I KONKURSEVE, EKSPOZITAVE, PREZANTIMET E KONKURSEVE PËR VEPRA ARKITEKTONIKE DHE PROJEKTE PEJSAZHORE DHE URBANISTIKE</p> <p>7.1. Shërbime të konsulences për organizim të konkurseve për projektimin e objekteve ndërtimore; përpilimi i programeve projektuese; paralogaritja e vlerës investive për nevoja të buxhetimit, angazhimi i ekipeve vlerësuese prej min. 3 persona, sipas kategorive:</p> <p>7.1.1. Konsulence për konkurse projektimi për kategorinë I</p> <p>7.1.2. Konsulence rekonstruimi për kategorinë I</p> <p>7.1.3. Konsulence për konkurse projektimi për kategorinë II</p> <p>7.1.4. Konsulence rekonstruimi për kategorinë II</p>
--	---

	<p>7.1.5. <i>Konsulence për konkurse projektimi për objekte të rëndësishë së veçantë ose të konkurse ndërkombëtare</i> <i>Çmimi të ipet sipas udhëzimeve në tabelat "Kuotimi i çmimeve"</i></p> <p>7.2. Shërbime të konsulences dhe organizimit të konkurseve të planifikimit hapësinor: hartimi dhe përpilimi i kërkesave programore; paralogaritja e vlerës së pritshme për nevoja të buxhetimit, propozimi, përzgjedhja dhe angazhimi i vlerësuesve profesional [min 3 vlerësues] 7.2.1. <i>Vlerësimet, parashikimet, leverdishmëria, programi projektues, organizimi i jurisë profesionale</i> <i>Çmimi të ipet sipas udhëzimeve në tabelat "Kuotimi i çmimeve"</i></p> <p>7.3. Shërbime të prezantimeve të konkurseve të arkitekturës, konkurseve të urbanistikës dhe arkitekturës peisazhore organizmi i ekspozitave të dixhitalizuara dhe të prezantimeve të vizatimeve të shtypura, të projekt propozimeve konkurruese, në portalin përkatës, për nevoja të publikimit, diskutimit dhe komentimet e publikut; votimi online i lidhur me sistemin e identifikimit të qytetareve [e-kosova] dhe publikimi i rezultateve, ndërlidhur me portalin Infofaqja Raportimi dhe dokumentimi i procesit vlerësues, publikimi i punimeve në portal, sipas kategorive përkatëse 7.3.1. <i>Shërbim për organizim për ekspozita të konkurseve të projektimit për kategorinë I</i> 7.3.2. <i>Shërbim për organizim për ekspozita të konkurseve të projektimit për kategorinë II</i> 7.3.3. <i>Shërbim për organizim për ekspozita të konkurseve të arkitekturës peisazhore</i> 7.3.4. <i>Shërbim për organizim për ekspozita të konkurseve të ose urbanizmit</i> 7.3.5. <i>Shërbim për organizim për ekspozita për konkurse projektimi për objekte të rëndësishë së veçantë ose të konkurse ndërkombëtare</i> <i>Çmimi të ipet sipas udhëzimeve në tabelat "Kuotimi i çmimeve"</i></p> <p>8. SHËRBIME NDIHMESE PROFESIONALE PËR NEVOJA TË DREJTORIVE ME PËRFSHIRJE SHËNIMESH, VLERËSIM DHE KONSULENCË</p> <p>8.1. Shërbim i kryerjes së verifikim inspektues gjatë pozicionimit të objektit me leje ndërtimore, në fazat përkatëse të ndërtimit, dokumentimi dhe publikimi i tyre në portalin përkatës, dokumentimi me procesverbal inspektues, dhe ndërlidhja me portalin e Drejtorisë së Inspektionit dhe të urbanizmit <i>Inxhinieri në teren, çmimi për 1 m²</i></p> <p>8.2. Shërbimi i kolaudit të objekteve për nevoja të lëshimit të Lejes së përdorimit /Certifikatës përdoruese, publikimi dhe azhurnimi komisionues prezantohet në portalin e qytetareve në kohe reale <i>Inxhinieri në teren, çmimi për 1 m²</i></p>
--	---

	<p>8.3. Përfshirja dhe transmetimi i shënimeve inxhinierike nga shënimet analoge ne ato dixhitale, nga projektet ekzistuese, me punë minimale të terrenit, kryesisht me verifikim vizuel dhe me foto dokumentim final si më poshtë:</p> <p>8.3.1. <i>Dokumentimi ne BIM 3D ne nivelin e zhvillimit kl. LOD 100</i></p> <p>8.3.2. <i>Dokumentimi ne BIM 3D ne nivelin e zhvillimit kl. LOD 300</i></p> <p>8.3.3. <i>Dokument. ne BIM 3D/4D ne nivelin e zhvillimit kl.LOD 450</i></p> <p>8.4. Matja lazerike e objekteve në teren, me përcjelljen e shënimeve të dixhtalizuara dhe përfshirjen e shënimeve të nevojshme për formimin e ardhëshëm të projekteve të trajtuara me menaxhimin informativ të godinave [BIM], me saktësi $\pm 2\text{cm}$</p> <p>8.4.1. <i>Dokumentimi i eksterierit, ne nivelin e zhvillimit kl. LOD 100</i></p> <p>8.4.2. <i>Dokumentimi i eksterierit, ne nivelin e zhvillimit kl. LOD 200</i></p> <p>8.4.3. <i>Dokumentimi i eksterierit, ne nivelin e zhvillimit kl. LOD 350</i></p> <p>8.4.4. <i>Dokumentimi i enterierit, ne nivelin e zhvillimit kl. LOD 100</i></p> <p>8.4.5. <i>Dokumentimi i enterierit, ne nivelin e zhvillimit kl. LOD 200</i></p> <p>8.4.6. <i>Dokumentimi i enterierit, ne nivelin e zhvillimit kl. LOD 350 (LOD shk. "Level of Development")</i></p> <p>8.5. Studimet, analiza dhe propozimet për mobilitet/trafik në raport me rrethinën dhe parkingjet, përgatitja e propozimeve për aprovim, në baze të shënimeve të pranuar nga ekipet tjera [numërimi i trafikut, ndërtimi i modelit simulativ, analiza e funksionalitetit dhe propozimit teknik të përmirësimit neper udhëkryqe dhe rruge], si propozim të zgjidhjes me arsyetim dhe prezantim tekstual, numerik dhe grafik të variantes me të përshtatshme të aplikueshme, për komunikacion në për udhëkryqe rrethore (O) Për udhëkryqe të degëzuara (X,Y)</p> <p>8.5.1. <i>Hulumtimi i trafikut te kategorisë I</i> <i>Komunikacioni udhëkryqe te vogla deri ne 3000m²</i> <i>Me një shirit në hyrje dhe një dalje në secilën degë.</i> <i>rreth rrotullim me diametër të jashtëm D=20 deri 45 m</i></p> <p>8.5.2. <i>Hulumtimi i trafikut te kategorisë II</i> <i>Komunikacioni udhëkryqe te vogla deri ne 3000-4000m²</i> <i>Me nga dy shirita në hyrje dhe dy në dalje</i> <i>rreth rrotullim me diametër të jashtëm D=45 deri 80 m</i></p> <p>8.5.3. <i>Hulumtimi i trafikut te kategorisë III</i> <i>Komunikacioni udhëkryqe te vogla deri ne 4000-5000m²</i> <i>Me nga tre ose më shumë shirit në hyrje dhe në dalje</i> <i>rreth rrotullim me diametër të jashtëm D>80 m</i> <i>Çmimi të ipet sipas udhëzimeve në tabelat "Kuotimi i çmimeve"</i></p> <p>8.6. Matjet gjeodezike për nevoja të planeve të zhvillimit të komunës, për verifikime dhe pozicionime të objekteve dhe infrastrukturës; prodhimi i të dhënave për formimin e kadastrit tokësor dhe nëntokësor, identifikimi i instalimeve nëntokësore, gjeopozicionimi dhe përfshirja në sistemin GIS në</p>
--	---

	<p>hartat përkatëse që do të zhvillohen gjatë zhvillimit të projektit; përfshi rilevimet dhe elaboratet përkatëse.</p> <p>8.6.1. Verifikimi i pozicionimit të objektit në teren</p> <p>8.6.2. Verifikimi i instalimeve për parcelat ndërtimore</p> <p>8.6.3. Verifikimi i gabariteve të etazheve të objekteve në ndërtim</p> <p>8.6.4. Verifikimi i situacioneve sipas planeve urbanistike</p> <p>8.6.5. Gjeopozicionimi i objekteve volumetrike në hartat digjitale</p> <p>8.6.6. Rilevime të rrugëve, shtigjeve, tubacioneve dhe të ngjashme</p> <p><i>Çmimi të ipet sipas udhëzimeve në tabelat "Kuotimi i çmimeve"</i></p>
6.2. Vendi i kryerjes së veprimtarisë	OE obligohet të siguroj hapësirë të mjaftueshme për kryerjen e veprimtarisë, për akomodimin e personelit, menaxherit të caktuar nga ana e AK, për prezantime të hulumtimeve, analizave dhe propozimeve, sallën e konferencave për takimet periodike, dhe të gjitha hapësirat tjera përcjellëse të cilat do të jenë të nevojshme për plotësimin e kërkesave që dalin sipas llojit të detyrave dhe metodologjisë së punës; do të siguroj mjetet e punës dhe pajimet e nevojshme për kryerjen e detyrave, dhe për mbledhjen e informatave, procesimin dhe përpunimin e tyre.
6.3 Mjetet të cilat duhet të sigurohen nga Konsulenti	OE do të sigurojë që ekspertët janë të mbështetur në mënyrë adekuate dhe të pajisur me mjete të nevojshme të punës.
6.4 Pajisjet	Të gjitha pajisjet duhet të sigurohen nga OE pa kosto shtese për AK.
6.5 Shpenzimet e rastit	Dispozita për shpenzime të rastit mbulohen nga OE në kuadër të kontratës.
7. RAPORTET	
7.1 Kërkesat e Raportimit	<p>Raportet e përkohshme duhet të përgatiten çdo një muaj gjatë periudhës së zbatimit të detyrave, gjegjësisht kontratës. Ato duhet të sigurohen dhe dorëzohen së bashku me faturën përkatëse periodike, raportin financiar dhe raportin e progresit. Duhet të jetë një raport përfundimtar, një faturë përfundimtare dhe raporti financiar i shoqëruar nga një raport i verifikimit të shpenzimeve në fund të periudhës së zbatimit të detyrave, të dorëzohen punët e realizuara në formë të shkruar dhe elektronike, Rregulloret, Manualët, skicat etj. të përmbledhura në projektin përfundimtar, për dorëzim.</p> <p>Për të përmbledhur, përveç dokumenteve, raporteve dhe rezultateve të cilat mund të specifikohen nën detyrat dhe përgjegjësitë e secilit ekspert kyç, Konsulenti duhet të sigurojë raportet e mëposhtme:</p> <p>Raportet Mujore</p> <p>Raportet Vjetore</p>
7.2 Dorëzimi & aprovimi i raporteve	Kopjet e raporteve të shënuara më lartë duhet të dorëzohen tek Menaxheri i Projektit, i identifikuar në kontratë. Raportet duhet të jenë të përpiluara në gjuhën shqipe. Menaxheri i Projektit është përgjegjës për miratimin e raporteve.
8.1 Monitorimi & Vlerësimi	Monitorimi dhe vlerësimi bëhet nga Projekt menaxheri dhe/ose Organi mbikëqyrës i projektit

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

NA

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA
NGA E EKSPËRTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

JO

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

OE ankues “Alb -Architect ” SH.P.K, Prishtinë, sipas nenit 4.1.26 të LPP-së janë palë me interes sepse mendojnë që të jenë pjesëmarrës me ofertën e tyre.

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTËT E NGJASHME

JO

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

JO

KRONOLOGJIA E ZHVILLIMIT TE PROCEDURES

PROCEDURË E KUFIZUAR FAZA PARË

- NJOFTIM PËR KONTRATË date 21.07.2022
- DOKUMENTI I PARAKUALIFIKIMIT PROCEDURA E KUFIZUAR Faza e parë datë 21.07.2022
 - Sqarimi i Aplikacioneve 10.08.2022
 - Afati i fundit i dorëzimit të aplikacioneve data 31.08.2022 koha 14:00:00
- NJOFTIM PER INFORMATA SHITESË ose PERMIRESIM I GABIMIT datë 28.07.2022
- NJOFTIM PER INFORMATA SHITESË ose PERMIRESIM I GABIMIT datë 29.07.2022
- Kërkesa për informata shtese OE Infra Plus SHPK datë 02.08.2022
- Letër standarde e kërkesës për sqarime të tenderit OE Master Architect SH.P.K. date 08.08.2022
- Kërkesa për informata shtese nga “Alb- Architect” sh.p.k. datë 08.08.2022
- Kërkesa për informata shtesë (shtyrje afatit)nga “Alb- Architect” sh.p.k datë 25.08.2022
- Vendimi për Rishqyrtim te ankesës se OE “Infra Plus” sh.p.k. dt. 26.08.2023 të datës 27.08.2022
- NJOFTIM PER INFORMATA SHITESË ose PERMIRESIM I GABIMIT datë 26.08.2022
 - Hapja e ofertave datë 31.08.2022
- RAPORTI I VLERËSIMIT TË APLIKACIONEVE LISTA E NGUSHTË datë 29.11.2022
- Njoftim mbi vendimin e autoritetit kontraktues datë 26.10.2022

PROCEDURË E KUFIZUAR FAZA DYTË

- DOSJA E TENDERIT “SHERBIMET KONSULENTE” PROCEDURË E KUFIZUAR FAZA 2 datë 08.12.2022

Raporti i Ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën numër PSH. Nr. 44/23, te “Alb -Architect ” SH.P.K, Prishtinë, pjesëmarrës në ftesën për ofertë lidhur me aktivitetin e prokurimit “Konsulencë për themelimin e Shërbimit të Arkitektit të Kryeqytetit për nevojat e Komunës së Prishtinës “ me numër të prokurimit: 616-22-7431-3-1-2 iniciuar nga AK/ – KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS,,
5/59

- Sqarimi i dosjes se tenderit date 19.12.2022
- Dorëzimi tenderëve para afatit kohorë 19.01.2023 në 14:00:00 orë.- (dy zarfa; kopje fizike)
- Kërkesa për informata shtese nga “Alb- Architect” SH.P.K. datë 13.12.2022
- Kërkesa për informata shtese nga “Gjeokonsult & CO” SH.P.K. datë 13.12.2022
- Kërkesa për informata shtese nga “Ardnovate shpk Branch in Kosovo” SH.P.K datë 16.12.2022
- Kërkesa për informata shtese nga “Gjeokonsult & CO” SH.P.K. datë 04.01.2023
- Kërkesa për informata shtese nga “Gjeokonsult & CO” SH.P.K. datë 06.01.2023
- Kërkesa për informata shtese nga “Alb- Architect” SH.P.K. datë 16.01.2022
- Vendimi për Rishqyrtim te ankesa datë 16.01.2023.
- Vendimi për Rishqyrtim te ankesa datë 17.01.2023.

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE “Alb -Architect ” SH.P.K, Prishtinë

PRETENDIMI 1

Lidhur me pretendimin e OE “Alb -Architect ” SH.P.K, Prishtinë se AK – Kuvendi i Komunës së Prishtinës – Me rastin e nxjerrjes së VENDIMIT të datës 17.01.2023 me te cilin HUDHET SI E JASHTË AFATSHME, kërkesa për rishqyrtim. ka vepruar në kundërshtim me paragrafin 5 të nenit 108A të LPP-se, dhe të paragrafit 4 të nenit 81 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative sepse në dosje theksohet se mund të parashtrahet kërkesa për rishqyrtim 5 ditë para dorëzimit të dosjeve, respektivisht para datës 19.01.2023, qe i bie dita e fundit për dorëzim 14.01.2023 (dite e shtune) sipas dispozitave te nenit te lartë cekur ky afat është dashtë të zgjatet deri në ditën e hënë respektivisht datë:16.01.2023.

PËRGJIGJEJE NË PRETENDIMI NR.1

Ekspertit shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga “Alb -Architect ” SH.P.K, Prishtinë duke u bazuar në faktet e prezantuar në dokumentacionin që kam pranuar në shqyrtim sqaron se AK -ja ka kërkuar me Dosja E Tenderit “Shërbimet Konsulente” Procedurë E Kufizuar Faza Dytë date 08.12.2022 me Seksioni II. Fleta e të dhënave të tenderit (FTD) neni 10.1 ka caktuar datën 19.12.2022 datën e fundit për kërkesë për Sqarim të Dosjes së Tenderit. Duke u bazuar ne Rregulloren Nr.001/2022 Për Prokurimin Publik nenin 24, Ofrimi i informacioneve shtesë ose sqarimeve dhe zgjatjet e afateve kohore, respektivisht paragrafi 24.1 thotë: Një OE, mund të kërkojë, me shkrim, informata shtesë sqaruese për dokumentet e tenderit nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik – vetëm nëpërmjet funksionit të dedikuar për kërkesa për sqarime ndërsa ne paragrafin 24.2 thotë: Një kërkesë e tillë me shkrim duhet të dërgohet përmes funksionit “sqarimet e DT” në platformën elektronike dhe duhet të pranohet nga AK brenda afatit kohor të specifikuar në DT. Nëse kërkesa për sqarime pranohet pas ditës së fundit të paraparë për sqarime në DT, kërkesa e tillë refuzohet dhe OE do të informohet për arsyen e refuzimit.

Eksperti shqyrtues sqaron se pretendimi i OE ankues se “ dita e pestë nga data e fundit për Sqarimin e dosjes se tenderit e datës -19.12.2022 është dita e 14.12.2022 (ditë e shtune) dhe se AK-ja është dashtë të zgjatë deri në ditën e hënë respektivisht datë 16.01.2022”, duke u bazuar ne LPP-në neni 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve paragrafi 3 thotë: Kërkesa për shqyrtim duhet të dorëzohet tek autoriteti përkatës kontraktues, me postë ose me çdo mjet tjetër të komunikimit të lejuar me këtë ligj, brenda afateve të mëposhtme, ndërsa në nën paragrafin 3.1 thuhet se: në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit brenda pesë (5) ditëve para afatit të fundit për dorëzim të ofertave,

Prandaj bazuar ne këto që u thanë me lart rezulton se ky pretendim i OE është i pa bazuar sepse kërkesa e tillë me shkrim duhet të dërgohet përmes funksionit “sqarimet e DT” në platformën elektronike e cila është e qasshme 24/7

PRETENDIMI 2

Lidhur me pretendimin e OE “Alb -Architect ” SH.P.K, Prishtinë, se AK – Kuvendi i Komunës së Prishtinës ka bërë shkelje të këtij neni Neni 72 të LPP -se duke mos ofruar informatat shtesë - sqarimet e kërkuara me datën 13.12.2022, respektivisht informata shtese sa i përket pikës së Vlerësimit të propozimeve teknike të parapara me dosjen e tenderit në fazën e dytë, të njëjtën kërkesë e kemi përsëritur me datën 28.12.2022. Ne arsyetimin e vendimit lidhur me refuzimin e kërkesës për rishqyrtim e potencon se kërkesa për informata shtese e datës 28.12.2022 është e paraqitur jashtë afateve respektivisht të datës 19.12.2022, Zyrtari kompetent në kuadër të AK me vetëdije e anashkalon apo e kamuflon shkeljen ligjore që e ka bërë me rastin e mos trajtimit dhe përgjegjësisë së kërkesës 13.12.2022

PËRGJIGJEJE NË PRETËNDIMI NR.2

Ekspertit shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga “Alb -Architect ” SH.P.K, Prishtinë duke u bazuar në faktet e prezantuar në dokumentacionin që kam pranuar në shqyrtim sqaron se OE ankues me datën 13.12.2022 ka bërë kërkesë për Informata shtesë për mes platformës elektronike e- prokurim nëpërmjet funksionit të dedikuar për kërkesa për sqarime ,

Njoftimet	Sqarimet e TD (pamje monitorimi)
<ul style="list-style-type: none"> Njoftimet Dosja e tenderit Aplikimet, Ofertat Sqarimet e DT Kërkesat për rishqyrtim Dokumentet - Letrat standarde Proces verbal, Raporti vlerësimit, Vendimi B58 Dëshmitë e pranueshmërisë Deklarata e Nevojave B04 Komunikim me AK Dokumentet lidhur me kontratat 	<p>Dërguar nga : " Infra-Plus " SH.P.K. Kërkesa për sqarime në DT Kerkese per informata shtese.pdf 02.08.2022 15:57</p> <p>Hape: Shkarko të gjithë dokumentacionin Shqip</p> <p>Dërguar nga : MASTER ARCHITECTS SH.P.K. Kërkesa për sqarime në DT Kerkese per Sqarime.pdf 08.08.2022 14:38</p> <p>Hape: Shkarko të gjithë dokumentacionin Shqip</p> <p>Dërguar nga : ALB - Architect SH.P.K. Kërkesa për sqarime në DT Kerkese shtyrje te dorezimit te parakualifikimit.pdf 25.08.2022 16:12</p> <p>Hape: Shkarko të gjithë dokumentacionin Shqip</p> <p>Dërguar nga : " AR & BUS" SH.P.K. Kërkesa për sqarime në DT Kerkese per sqarim per KK Prishtine.pdf 02.09.2022 14:53</p> <p>Hape: Shkarko të gjithë dokumentacionin Shqip</p> <p>Dërguar nga : ALB - Architect SH.P.K. Kërkesa për sqarime në DT Kerkese per informata shtese-Arkitekti i Qytetit.pdf 13.12.2022 14:39</p> <p>Hape: Shkarko të gjithë dokumentacionin Shqip</p>

Ak-ja ketë kërkesë për informata sqaruese nuk e ka shqyrtuar sipas paragrafit 24.3 te nenit 24 te RREGULLORES Nr.001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK, Ne mungesë të pergjigjejes për informata

sqaruese nga AK-ja, OE “Alb Architect” sh.p.k. i drejtohet dhe një here me datën 28.12.2022 AK-së me kërkesë për informata sqaruese,

<ul style="list-style-type: none"> Njoftimet Njoftimet Dosja e tenderit Aplikimet, Ofertat Sqarimet e DT Kërkesat për rishqyrtim Dokumentet - Letrat standarde Proces verbal, Raport vlerësimit, Vendimi B58 Dëshmitë e pranueshmërisë Deklarata e Nevojave B04 Komunikim me AK Dokumentet lidhur me kontratat Përmbledhja Operimi me prokurim 	<h3>Dokumentet tjera (pamje monitorimi)</h3> <hr/> <p>Dërguar nga : Arduovatic SHPK Branch in Kosovo</p> <p>Dokumenti për dërgim te AK</p> <p>Kerkese per Sqarime SAQ_Ardnovatic_PBC.pdf 19.12.2022 14:28</p> <p>Hape: <input type="button" value="Shqip"/></p> <hr/> <p>Dërguar nga : ALB - Architect SH.P.K.</p> <p>Dokumenti për dërgim te AK</p> <p>Kerkese per informata shtese Arkitekti i Qytetit.pdf 28.12.2022 09:35</p> <p>Hape: <input type="button" value="Shqip"/></p>
--	---

Autoriteti kontraktues edhe këtë herë kërkesës për informata sqaruese nuk i jep përgjigjeje e kërkuar nga OE

Procurement Number: 616 22 7431-3-1-2 Title: Konsulencë për themelimin e Shërbimit të Arkitektit të Kryeqytetit për nevojat e Komunës së Prishtinës

Aneksi 3. KËRKESA PËR INFORMACIONE SHITESË

Për: KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES

DUKE MARRË PARASYSH SE [ALB-Architect sh.p.k] (më tej "Operatori Ekonomik"), pas pranimit të dosjes së tenderit nën Nr. e Prokurimit të sipër-përmendur, beson se nevojiten informacionet shitesë ose informacionet sqaruese si në vijim:

Identifikimi i informacioneve shitesë ose i informacioneve sqaruese, përfshirë referencat në pjesën apo në pjesët e dosjes së tenderit. Te nderuar, ne dosjen e tenderit që kemi dërguar si faze për fazën e dytë, kemi përfshirë në disa pika:

Qëllimi i Kontratos Pika 3.1: Qëllimi i këtij projekti është si më poshtë:

- Analiza e gjendjes ekzistuese, inçizimi i rrugëve dhe hapësirave publike, krijimin e një data baze për regjistrim të elementeve të sigurisë së trafikut rrugor, rritjen e sigurisë në komunikacionin rrugor, përmirësimi i nivelit të shërbimit të rrugëve në zonën urbane, përcaktimin e lokacioneve se ku duhet të vendosen shenja, shtylla antipark, retrovizor, guarga artificiale, shporta, ulëse, rrethoja dhe elemente tjera të sinjalizimit horizontal dhe vertikal dhe të mobilitetit urbane.
Kjo pikë nuk përfshijë termat e referencës për këtë projekt, lutem që të na jepni sqarime në këtë mespërputhshmëri.

Përshkrimi i propozimeve teknike Pika 23.1: Përshtatshmëria e Metodologjisë së propozuar dhe planit të punës në përgjigjen ndaj TER:

Ne si konzorcium, ne fazën e parë kemi dorëzuar Metodologjinë, planin e punës, organogramin, referencat, si dhe stafin kryesor dhe stafin ndihmes (sic kane qene kerkesat ne dosjen e tenderit ne fazen e pare), vlen te ceket qe per te njejten qeshtje kemi bere kerkese per informata shitese edhe ne fazen e pare, dhe pergjigja juaj ka qene qe keto duhet te dorëzohen ne fazen e pare.

Te bashkëngjitur gjëni pyetjen e bërë nga ne dhe përgjigjen që kemi pranuar nga ju.

Pyetja jone eshte: Pse te njejtat jane kerkuar edhe ne fazen e dyte?

Ne mendojm qe kjo kerkese eshte ezauruar ne fazen e pare te tenderimit.

Lutem qe te na njoftoni per kete qeshtje.

PRANDAJ, unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar Operatorin Ekonomik, nëpërmjet kësaj kërkoj marrjen e informacioneve të identifikuar.

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)	
Emri OE:	ALB-Architect sh.p.k
Adresa e plotë:	Rr. Isa Kastrati nr.9-Prishtine
I përfaqësuar nga:	
Emri:	Afrim Demiri
Pozita:	Drejtor Menaxhues
Nënshkrimi:	
Data:	13.12.2022
Vula:	

Autoriteti kontraktues edhe këtë herë kërkesës për informata sqaruese nuk i jep përgjigjejen e kërkuara nga OE, në mungesë të përgjigjes për informata sqaruese nga AK-ja, OE "Alb Architect" SH.P.K. i drejtohet dhe një herë me datën 16.01.2023 në orën 15:57 për mes platformës elektronike e-prokurim AK-së, këtë herë me kërkesë për Rishqyrtim,

Njoftimet

Njoftimet

Dosja e tenderit

Aplikimet, Ofertat

Sqarimet e DT

Kërkesat për rishqyrtim

Dokumentet - Letrat standarde

Proces verbal, Raporti vlerësimit, Vendimi B58

Dëshmitë e pranueshmërisë

Deklarata e Nevojave B04

Komunikim me AK

Dokumentet lidhur me kontratat

Përmbledhja

Operimi me prokurim

Pergaditja e procedurës

Kërkesat për rishqyrtim

Sqarimet e DT

Korrigjimi i procedurës

Hapja e kërkesave për pjesëmarrje

Vlerësimi i aplikacioneve

Fleša për tenderin

Hapja e tenderëve

Vlerësimi i tenderëve

Publikimi i B58

Dhënia e kontratës

Draft i kontratës

Nënshkrimi i kontratës

Ankesat

Anulimi i procedurës

Mënyshimi në dhënie të kontratës

Dokumentet - Letrat Standarde

Kërkesat për rishqyrtim (pamje monitorimi)

Dërguar nga : KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES

Vendimi i AK në Kërkesën për rishqyrtim

Vendim i kërkeses per rishqyrtim - Konsulence per sherbimin e arkitektit....PDF

29.08.2022 11:52

Hape:

Shkarko të gjithë dokumentacionin

Shqip

Dërguar nga : KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES

Vendimi i AK në Kërkesën për rishqyrtim

Vendim per rishqyrtim - Sherbimi i arkitektit.PDF

03.11.2022 11:56

Hape:

Shkarko të gjithë dokumentacionin

Shqip

Dërguar nga : KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES

Vendimi i AK në Kërkesën për rishqyrtim

Vendim per rishqyrtim - sherbimi i arkitektit.PDF

16.01.2023 15:57

Hape:

Shkarko të gjithë dokumentacionin

Shqip

Dërguar nga : KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES

Vendimi i AK në Kërkesën për rishqyrtim

Vendim per rishqyrtim - Sherbimi i arkitektit 2...PDF

17.01.2023 13:25

Hape:

Shkarko të gjithë dokumentacionin

Shqip

AK-ja për këtë kërkesë për rishqyrtim me datën 16.01. 2023 nxjerr Vendim me te cilin kërkesa Hudhet si e jashtë ligjshme me arsyetim se nuk është përmbushur sipas formularit zyrtar i cili është i ngarkuar në sistemin elektronik E-prokurim ku në Kërkesën e tij për Rishqyrtim ka paraqitur vetëm pjesën e parë të formularit dhe pjesën tjetër nuk e ka paraqitur siç janë pretendimet ankimore dhe pretendimet e shkeljeve ligjore, Eksperti shqyrtues sqaron se AK-ja në këtë rast ka qen i detyruar të veproj në bazë të LPP-së neni 108/A Zgjidhja preliminare, paragrafi 5- Nëse aplikimi nuk përmban disa nga informacionet referuar në paragrafin 4 të këtij neni, autoriteti kontraktues do të kërkojë nga ankuesi që të plotësoj kërkesën e tij Brenda një periudhe jo më të gjatë se dy (2) ditë nga marrja e kërkesës. Nëse parashtuesi i ankesës nuk vepron sipas kërkesës së lartpërmendur, kërkesa për rishikim do të refuzohen si e paplotë.

Departamenti i Prokurimit

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 23.10.2022 të parashtruar nga Operatori Ekonomik “Alb Arkitekt” Shpk, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Konsulencë për themelimin e Shërbimit të Arkitektit të Kryeqytetit për nevojat e Komunës së Prishtinës”, me Nr. të Prok: 616 22 7431 312 dhe numër të brendshëm: 616 23 108 312 nxjerr:

V E N D I M

1. Hudhet si e jashtë ligjshme kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik “Alb Arkitekt” Shpk të dt. 13.01.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit : 616 22 7431 312, kundër *Njoftimit për Kontratë* të AK –së, të datës 21.07.2022 të publikuar në web-faqe të KRPP-së.
2. Vërtetohet *Njoftimit për kontratë* i AK –së i publikuar me datë: **21.07.2022**
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që *te vazhdoj me aktivitetin e prokurimit për tenderin* “Konsulencë për themelimin e Shërbimit të Arkitektit të Kryeqytetit për nevojat e Komunës së Prishtinës”, me Nr. të Prok: 616 22 7431 312 dhe numër të brendshëm: 616 23 108 312, sipas *Njoftimit për kontratë* të datës: 21.07.2023.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik “Alb Arkitekt” Shpk me datë 13.01.2023 ka parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Konsulencë për themelimin e Shërbimit të Arkitektit të Kryeqytetit për nevojat e Komunës së Prishtinës”, me Nr. të Prok: 616-22-7431-3-1-2 dhe numër të brendshëm: 616 22 108 312.

Autoriteti Kontraktues duke u mbështetur në LPP dhe në Rregulloren për Prokurim Publik nr. 001/2022 në nenin 62 dhe 63.1.1 pika b. OE "Alb Architekt" Shpk në kërkesën e tij për rishqyrtim nuk ka paraqitur asnjë pretendim ankimor andaj kërkesa për rishqyrtim e OE është e pabazuar, e jashtëligjshme. Bazuar në këtë AK nuk e shqyrton kërkesën për rishqyrtim për faktin që OE me datë 13.01.2023, ka paraqitur kërkesën për rishqyrtim e cila nuk është e përbushur sipas formularit zyrtar i cili është i ngarkuar në sistemin elektronik E-Prokurimi ku në Kërkesën e tij për Rishqyrtim ka paraqitur vetëm pjesën e parë të formularit dhe pjesët tjera nuk i ka paraqitur sic janë pretendimet ankimore dhe pretendimet e shkeljeve ligjore, andaj në pamundësi për të shqyrtuar kërkesën për rishqyrtim e cila nuk është e precizuar në pretendime ankimore AK vendos si në dispozitivin e lartcekur.

Mirëpo për hire të respektimit të parimit të ligjshmërisë AK ju përgjigjet se ju keni pasur të drejtë të paraqitni kërkesë për sqarime deri me datë 19.12.2022 e cila është e cekur në dosje të tenderit dhe ju keni paraqitur kërkesë për sqarime me datë 28.12.2022 e cila është në kundërshtim me dispozitën e cekur në dosje të tenderit.


Poashtu ju me datë 16.01.2023 dorëzoni kërkesën për rishqyrtim prapë në mënyrë tjetër duke shkelur udhëzimin për ushtrimin e mjetetit juridik të precizuar. AK ju konfirmon që kërkesa e juaj për rishqyrtim e zyrtarizuar është e datës 13.01.2023 e cila kërkesë nuk është e precizuar dhe është në gabim.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Bashkangjitur:

Kërkesa për rishqyrtim e OE Alb Architekt

Prishtina: datë. 16.01.2023

Nexhmi Mekolli

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit

AK-ja nuk vepron sipas nenit 108/a paragrafi 5 por nxjerr vendim dhe kërkesa për rishqyrtim Hudhet si e jashtë ligjshme dhe njëherit dhe kërkesën për sqarim nga OE "Alb Architect" sh.p.k. të datës 28.12.2022 e trajton në kundërshtim me dispozitën e cekur në dosjen e tenderit. Mirëpo nuk e merr për bazë kërkesën për informata sqaruese të parashtruar me datën 13.12.2022 në pajtim me dispozitën e cekur në dosjen e tenderit Seksioni II. Fleta e të dhënave të tenderit (FTD) nenin 10.1 Sqarimi i Dosjes së Tenderit ku është përcaktuar data 19.12.2022 për të cilën kërkesë nuk ka dhënë përgjigjeje.

Prandaj bazuar në këto që u thanë më lart rezulton se ky pretendim i OE është i bazuar

PRETENDIMI 3

Lidhur me pretendimin e OE "Alb -Architect " SH.P.K, Prishtinë se AK – Kuvendi i Komunës së Prishtinës ka dështuar në hartimin e Dosjes se tenderit Neni 27 te LPP-se për fazën e parë respektivisht në kriteret për vlerësimin e aplikacioneve duke parapare të njëjtat edhe në dosjen e tenderit për fazën e dytë respektivisht në kriteret për vlerësimin e propozimit teknik AK ka vepruar në kundërshtim me paragrafin 3 të këtij neni (Neni 33 të LPP-së) kur i ka hartuar ose paraparë kriteret e përzgjedhjes identike në të dy fazat, ne si Grupi i OE "Alb-Architect" Sh.P.K. kemi paraqitë kërkesë për sqarim me njoftim që këto kriteret të përdorura në fazën e parë janë në kundërshtim me LPP, sepse nga praktika dhe LPP janë për fazën e dytë, fatkeqësisht AK nuk e merr parasysh kërkesën me sqarim parasysh - për bazë. AK ka bërë shkelje flagrante dhe të qëllimshme paragrafin 4, të nenit 52 të LPP, as një periudhe nuk ka shpreh interesimin e evitimit të kësaj shkelje edhe pse ne në vazhdimësi në përputhje me afatet ligjore kemi shpreh pakënaqësitë respektivisht shkeljen.

Një shkelje e tillë do të kërkohej të veprohet nga KRPP sipas pikës II të nenit 43.8 të Rregullorja 001/2022 për Prokurimin Publik i cili e rregullon si në vijim : Procedura e prokurimit para hapjes së ofertave mund të anulohet për arsye të mëposhtme: i. nëse AK gjatë përgatitjes dhe udhëheqjes së procedurës ka përdorur gabimisht opcionin për procedurën përkatëse dhe i cili gabim me verifikim të KRPP-se është i pariparueshëm; AK ka përdorur gabimisht në procedurën e kufizuar kriteret e vlerësimit të aplikacionit dhe Kriteret e vlerësimit të propozimeve teknike, në të dy fazat janë identike,

Shumë qartë e thekson Rregullorja 001/2022 për Prokurimin Publik në neni 27.10 si në vijim: Duhet të ketë kujdes për të siguruar që kriteret minimale për kualifikim (kriteret e përzgjedhjes) nuk përdoren si kriteret në procesin e dhënies së kontratës. Tenderuesit do të konsiderohen të kenë përmbushur kërkesat minimale në lidhje me kapacitetin e tyre për të përformuar kontratën që do të thotë që kriteret në lidhje me përvojat paraprake dhe historikut të kompanisë nuk do të shihen si kriteret në procesin e dhënies së kontratës.

Sipas nenit 27.7 të Rregullorja 001/2022 për Prokurimin Publik theksohet si në vijim:

Nëse autoriteti kontraktues gjatë procedurës së prokurimit kupton që kriteret e përdorura janë të papërshtatshme për të përcaktuar tenderin ekonomikisht më të favorshëm, përmirësimi i vetëm i situatës është anulimi i procedurës dhe tenderit. Duke u bazuar në këtë pikë ne do të marrim të gjitha veprimet e nevojshme që kjo shkelje ligjore të përmirësohet.

PËRGJIGJEJE NË PRETËNDIMI NR.3

Ekspertit shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga "Alb -Architect " SH.P.K, Prishtinë duke u bazuar në faktet e prezantuar në dokumentacionin që kam pranuar në shqyrtim sqaron AK-ja duke u bazuar në LPP-në nenin 53 si dhe nenin 24 te Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik paragrafi 24.2 Një kërkesë e tillë me shkrim duhet të dërgohet përmes funksionit "sqarimet e DT" në platformën elektronike dhe duhet të pranohet nga AK brenda afatit kohor të specifikuar në DT. Nëse kërkesa për sqarime pranohet pas ditës së fundit të paraparë për sqarime në DT, kërkesa e tillë refuzohet dhe OE do të informohet për arsyen e refuzimit. Një kërkesë e dorëzuar pas afatit të parapare për sqarime mund të shqyrtohet dhe nëse konsiderohet se është në interes të AK, e njëjta mund të pranohet. Ndërsa në paragrafin 24.4 thuhet: AK do të shqyrtoj menjëherë kërkesën sipas paragrafit 24.3 të kësaj rregullore dhe do të konstatoj nëse informata shtesë ose sqarimi i kërkuar është i nevojshëm apo jo.

a. Nëse jo AK do të informoj menjëherë, përmes platformës, OE në fjalë për mohim.

b. Nëse po AK do të ofrojë informatat shtesë menjëherë, përmes platformës, por nuk do të bëjë të ditur burimin e kërkesës së tillë.

Ndërsa paragrafi 24,5 thotë: Nëse, gjatë një procedure të hapur, të kufizuar apo konkurruese me negociata, informata shtesë apo sqaruese ofrohen për OE-të, dhe data kur ofrohen këto informata është më pak se dhjetë (10) ditë nga afati i fundit për dorëzim të tenderit, AK do të zgjatë afatin kohor për të dhënë mundësi OE të paktën 10 ditë për dorëzimin e tenderëve duke përgatitur dhe publikuar Njoftimin për Korrigjim të procedurës,

Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar dhe AK-ja ka qenë i obliguar të jap përgjigjejet e kërkuar nga OE dhe të veprojë në bazë të nenit 24 përkatësisht paragrafit 24.4 dhe 24.5 të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Ekspertit Shqyrtues i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa: “Alb-Architect” Sh.P.K., ankues të merret si e **bazuar**. Të behet anulimi i Vendimit Mbi Pezullimin e Aktivitetit të Prokurimit, të shqyrtojë kërkesën e OE duke i dhënë informata sqaruese të kërkuar, të bejë zgjatjen e dorëzimit të ofertave sipas nenit 24 përkatësisht paragrafit 24.4 dhe 24.5 të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik.

Raporti i Ekspertizës të dorëzohet:

Autoritetit Kontraktues	– KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
Panelit Shqyrtues	– OSHP-së.
OE ankues	– “Alb-Architect” Sh.P.K.,